


**STUDIM
ZHVILLIMI RURAL NE RRETHIN E PUKES**



PERMBAJTJA

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
KREU 1: OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA E STUDIMIT	7
1.1. Objektivat	7
1.2. Metodologjia	7
1.3. Problemet dhe kufizimet	7
KREU 2: REZULTATET E STUDIMIT	8
2.1. Informacion i përgjithshëm mbi rrethin e pukës	8
2.1.1. <i>Gjeografia dhe sipërfaqja e Rrethit të Pukës</i>	8
2.1.2. <i>Ndarja administrative dhe popullsia</i>	9
2.2. Arsimi në rrethin e Pukës	11
2.3. Kujdesi shëndetësor në Rrethin e Pukë	12
2.4. Punësimi dhe mbrojtja sociale në Rrethin e Pukës	12
2.5. Sektori i bujqësisë në rrethin e pukës	16
2.5.1. <i>Vendi i bujqësisë, toka bujqësore dhe reforma e tokës, dhe administrimi publik i bujqësisë</i>	16
2.5.2. <i>Prodhimi bujqësor</i>	17
2.6. Sektori i blegtorisë	20
2.6.1. <i>Tradita në blegtori, llojet e kafshëve, dhe madhësia e fermave blegtorale</i>	20
2.6.2. <i>Prodhimi blegtoral dhe destinacioni i tij</i>	22
2.6.3. <i>Matrikullimi dhe çertifikimi i bagëtive dhe luftimi i sëmundjeve tek bagëtitë</i>	24
2.7. Mekanizimi dhe inputet bujqësore	25
2.7.1. <i>Mekanizimi i bujqësisë në Rrethin e Pukës</i>	25
2.7.2. <i>Inputet bujqësore</i>	26
2.8. Agro-biznesi	27
2.9. Mbeshtetja për zhvillimin rural në rrethin e Pukës	27
2.10. Pyjet dhe prodhimet e pyllit	28
2.10.1. <i>Vendi i pyjeve në rrethin e Pukës</i>	28
2.10.2. <i>Bimët mjekësore dhe prodhimet e tjera të pyllit</i>	30
2.10.3. <i>Administrimi i pyjeve</i>	30
3. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	32
3.1. Konkluzione	32
3.2. Rekomandime	34
SHTOJCAT	36
Shtojca 1: Lista e monumenteve të natyrës në rrethin e Pukës	36
Shtojca 2: Popullsia e Rrethit të Pukës sipas ndarjes administrative	37
Shtojca 3: Lindjet dhe vdekjet 0-1 vjeç në Rrethin e Pukës në 2011 dhe disa krahasime me 2010	39
Shtojca 4: Kulturat bujqësore	40
Shtojca 5: Lista e organizatave jo-qeveritare që janë aktive në rrethin e Pukës	42

MIRENJOHJE

Ky studim mbi zhvillimin rural në Rrethin e Pukës është realizuar nga shoqata Agropuka në kuadrin e projektit “Të kontrojmë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetësës në zonat rurale të Pukës.” Ne falenderojmë Qendrën e Kooperativave të Suedisë (Swedish Cooperative Centre, SCC) për mbështetjen e këtij studimi. Gjithashtu, falenderojmë përfaqësuesit e institucioneve lokale partnerë të Agropukës, shtetërore dhe jo-shtetërore, që kontribuan me informacionet kohën dhe e tyre. Së fundi, ky studim u mundësua nga angazhimi i anëtarëve të Agropukës dhe konsulencën e Qendrës Kombëtare Burimore të Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC).

AGROPUKA, Shtator 2012

SHKURTIMET

AKU	Autoriteti i Kontrollit të Ushqimeve
ANTTARC	Albanian National Training and Technical Assistance Resource Center (Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike)
DRUMK	Drejtorinë Rajonale Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
DSHP	Drejtorisë Shërbimit Pyjor
IFAD	International Fund for Agriculture Development (Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë)
MADA	Mountain Area Development Agency (Agjensia e Zhvillimit të Zonave Malore)
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
NB	Ndërmarrjes Bujqësore
OFID	Fondin e OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar
OJF	Organizata Jo-Fitimprurëse
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
RASP	Rural Association Support Programme (Programi për Mbështetjen e Shoqatave Rurale)
SMT	Stacioni i Makinave dhe Traktorëve

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Studimi "Zhvillimi rural në Rrethin e Pukës" synon të vlerësojë situatën e zhvillimit rural në rrethin e Pukës dhe të sigurojë një material informativ për organizatat e ndryshme që janë prezent apo kanë objektiva të marrin pjesë në zhvillimin rural të Pukës. Objektivat specifike të studimit janë: (a) Të analizojë gjendjen e zhvillimit rural në rrethin e Pukës; dhe (b) Të identifikojë problemet, sukseset, nevojat dhe fushat prioritare të ndërhyrjes.

Studimi u bazua në informacionin e siguruar si nga rishikimi i dokumenteve/literaturës zyrtare si dhe të dhënave të tjera të botuara për situatën e zhvillimit rural në rrethin e Pukës si dhe intervistat me punonjës të institucioneve lokale, të qeverisjes vendore, bujqësisë, edukimit, shëndetësisë, sigurimit social, dhe punësimit.

Rrethi i Pukës është pjesë administrative e Qarkut të Shkodrës, shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë Veriore dhe ka një sipërfaqe prej 1033,69 km² me një popullsi prej 33.145 banorë. 20 vitet e fundit, popullsia e Pukës është përgjysmuar si pasojë e migrimit drejt qyteteve të mëdha dhe jashtë vendit për shkak të kushteve të vështira të jetesës, sidomos në zonat rurale. Puka përbëhet nga dy bashki--Pukë dhe Fushë-Arrëz--dhe tetë komuna--Blerim, Fierzë, Gjegjan, Iballë, Qafë -Mali, Qelëz, Qerret dhe Rrape. Puka ka dy qytete dhe—Pukën dhe Fushë Arrëzin--dhe 76 fshatra.

Rrethi i Pukës ka burime natyrore të pasura. Në Malësinë e Pukës gjen të gjitha brezat bimorë--nga shkurret mesdhetare, dushqet, dhe pyjet e pishës, bredhit dhe ahut, deri tek kullotat verore në lartësi. Në pyjet e Pukës strehohet një faunë e pasur ku ndeshen ujku, dhelpra, lepuri, vjedulla, derri i egër, dhia e egër, ariu si dhe shumë shpendë si thëllëza, pëllumbi i egër, gjeli i egër, etj. Rrethi i Pukës përshkohet nga ujëderdhje të shumta, që burojnë prej vargmaleve, të ndërprerë mes tyre me lugina të thella e qafa të ngushta. Klima është kontinentale me reshje të shumta (rreth 2020 mm/vit).

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore të studimit janë:

- Në Rrethin e Pukës, bujqësia është sektori kryesor i ekonomisë dhe burimi i vetëm i të ardhurave për mbi 70 % e popullsisë që jeton në fshat. 20 vitet e fundit, toka bujqësore është reduktuar si pasojë e lënjes djerrë, erozionit, varfërimit nga mos-qarkullimi i kulturave bujqësore, etj. Mbështetja nga qeveria dhe donatorët e ndryshëm kanë ndikuar në shtimin e sipërfaqeve të mbjella me pemë dhe numrit të rrënjëve. Bujqësia duhet të konsiderohet si prioritet zhvillimi edhe për të ardhmen. Në këtë kontekst duhet të mbrohet toka bujqësore, të pasurohet dhe futet nën kulturë, të stimulohet dhe subvencionohet mbjellja e pemëve frutore dhe veçanarisht arvoreve, dhe të orientohen fermerët në kulturat bujqësore më fitimprurëse. Masa të tilla do të rrisin punësimin dhe të ardhurat për familjet fermere.
- Blegtoria zë peshën kryesore të të ardhurave nga sektori i bujqësisë. Por zhvillimi i saj ekstensiv ka bërë që të ketë rendimente të ulëta dhe prodhim të vogël. Shembujt e fermave që kanë mbi 50 krerë të imëta dhe mbi 10 krerë gjedhë dhe rezultatet e tyre pozitive tregojnë për potencialin e sektorit. Puka ka një kapacitet kullosor për të mbajtur trefishin e numrit aktual të blegtorisë së

imët. Është e rëndësishme të nxitet dhe subvencionohet shtimi i numrit të krerëve në blegtorinë e imët, sidomos dhive, krahas përmirësimit racor të tyre. Megjithë shtimin mbi 7 herë të numrit të zgjojeve të bleteve dhe të prodhimit të mjaltit, kërkesat e tregut lokal dhe kombëtar nuk plotësohen. Rritja e prodhimeve të bletarisë duhet të bëhet si nëpërmes shtimit të zgjojeve të bletëve ashtu edhe rritjes së rendimentit.

- Mekanizimi i proceseve të punës në bujqësi dhe blegtori është në nivele të ulëta. Jo më shumë se 15% e tokës nën kulturë punohet me mjete të mekanizuara. Në blegtori dhe agropërpunim mekanizimi është kufizuar vetëm në ndonjë makineri të thjeshtë, kryesisht të vëna në punë me krahë. Inputet bujqësore janë të pakontrolluara e të paçertifikuara dhe tregëtohen jashtë rregullave e kushteve duke abuzuar me llojet, cilësinë dhe garancinë. Rritja e shkallës së mekanizimit dhe përdorimi sipas standarteve e kushteve të sigurisë të inputeve bujqësore është domosdoshmëri për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë në të ardhmen.
- Agrobiznesi mbetet pika më e dobët në Rrethin e Pukës. Mungesa e eksperiencës, kooperimit dhe infrastrukturës bëjnë që mbi 80 % e prodhimit bujqësor e blegtoral të destinohet për konsum në familje. Edhe prodhimi i destinuar për treg shpesh herë nuk realizohet për shkak të marketingut të pamjaftueshëm dhe mentalitetit individualist. Nxitja e agrobiznesit dhe prodhimit për treg, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së prodhimit dhe të një marketingu të fuqishëm, duhet të jenë në fokusin e aktorëve të zhvillimit rural.
- Fondi pyjor ku përfshihen zonat me bimësi pyjore, kullotat, sipërfaqet djerrë dhe inproduktive zë rreth 80% të sipërfaqes së Rrethit Pukë. Pyjet dhe kullotat në Pukë ofrojnë prodhime, shërbime dhe funksione mjedisore të pazëvendësueshme dhe banorët e zonave rurale e kanë të lidhur ngushtë jetesën e tyre me këto pasuri natyrore. Bimët mjekësore, etero-vajore dhe frutat e pyllit janë një burim i madh të ardhurash për popullsinë e Rrethit të Pukës. Deri më tani nuk janë shfrytëzuar as 30 % e kapacitetit prodhues. Mbjellja e tokave djerrë dhe me prodhimtari të ulët me këto bimë perveçse do të mbrojë tokën nga erozioni, do të përmirësojë ambientin duke e gjelbëruar atë. Njëkohësisht do të ishte edhe një burim i konsiderueshem të ardhurash për popullsinë e këtij rrethi.
- Është e nevojshme që të hartohet një strategji afat-mesme dhe afat-gjatë e zhvillimit rural në bazë rrethi. Në zhvillimin e kësaj strategjie duhet të marrin pjesë aktive të gjithë Njësitë e Qeverisjes Vendore si dhe anëtarët e komunitetit. Kjo strategji duhet të jetë rezultat i diskutimeve dhe analizave të thelluara dhe të paanshme sektoriale, krahinore dhe politiko-shoqërore. Paralel me strategjinë, duhet të iniciohen plane e projekte zhvillimi për përmirësimin e infrastrukturës, duke përcaktuar më parë prioritetet e zhvillimit, për të nxitur punësimin dhe reduktuar varfërinë e tejskajshme në këtë rreth.

KREU 1: OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA E STUDIMIT

1.1. Objektivat

Objektivi kryesor i këtij studimi është të vlerësojë situatën e zhvillimit rural në rrethin e Pukës dhe të sigurojë një material informativ për organizatat e ndryshme që janë prezent apo kanë objektiva të marrin pjesë në zhvillimin rural të Pukës. Objektivat specifike të studimit janë:

- a) Të analizojë gjendjen e zhvillimit rural në rrethin e Pukës; dhe
- b) Të identifikojë problemet, sukseset, nevojat dhe fushat prioritare të ndërhyrjes.

1.2. Metodologjia

Studimi u bazua në informacionin e siguruar si nga burime primare ashtu edhe ato sekondare. Informacioni primar u siguroi nga intervistat me punonjës të institucioneve lokale, të qeverisjes vendore, bujqësisë, edukimit, shëndetësisë, sigurimit social, dhe punësimit. Ndërsa informacioni sekondar u siguroi nga rishikimi i dokumenteve/literaturës zyrtare si dhe të dhënave të tjera të botuara për situatën e zhvillimit rural në rrethin e Pukës.

1.3. Problemet dhe kufizimet

Studimi do të shërbejë si një material orientues dhe informues për organizatat që janë present apo synojnë të marrin pjesë në zhvillimin rural të Pukës. Studimi ndeshi në problemet dhe kufizimet e mëposhtme:

- a) Ishte e vështirë të mblidheshin të dhëna për sektorët përkatës për periudha të njejta me synim krahasimin e tyre me gjendjen aktuale; dhe
- b) Studimi është fokusuar në bujqësi, blegtori, agro-biznes, dhe pyjet dhe prodhimet e pyllit me synim dhënien e rekomandimeve për zhvillimin e metejshëm rural në rrethin e Pukës. Informacioni mbi arsimin, shëndetësinë, dhe punësimin është dhënë në funksion të kësaj analize.

KREU 2: REZULTATET E STUDIMIT

2.8. Informacion i përgjithshëm mbi rrethin e Pukës

Rrethi i Pukës është pjesë administrative e Qarkut të Shkodrës. Qarku Shkodër renditet i pesti në Shqipëri për sa i përket numrit të popullsisë dhe i dyti për sa i përket sipërfaqes në të cilën ai shtrihet. Ai ka një dendësi mesatare rreth 71.8 persona për km², më e vogël kjo se mesatarja e vendit. Sipas ndarjes administrative të vitit 2000, popullsia e qarkut Shkodër është e përhapur në tre rrethe—Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Qarku përfshin: 5 Bashki dhe 29 komuna; 6 qytete dhe 269 fshatra. Në rrethin e Shkodrës në fshat banojnë 53.7% e popullsisë, ndërsa në dy rrethet e tjera--Malësi e Madhe dhe Pukë--popullsia që banon në zonat rurale përbën respektivisht 89% dhe 82% të popullsisë.

2.8.1. Gjeografia dhe sipërfaqja e Rrethit të Pukës

Rrethi i Pukës shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë Veriore (në hartën botërore shtrihet 42°2'39" në veri të ekuadorit dhe 19°53'58" në lindje të meridianit të parë). Puka shtrihet përgjatë krahut të majtë të lumit Drin, që nga Ura e Vezirit e Fusha e Dukagjinit në lindje dhe deri në afërsi të grykëderdhjes së lumit Gomsiqe në perëndim. Nga jugu, Puka kufizohet me Mirditën në kreshtat malore të Majës së Runës, Thirrës, Majës së Roshit, dhe Bjeshkëve të Tërbunit. Rrethi i Pukës ka një sipërfaqe prej 1033,69 km².

Rrethi i Pukës është i pasur në burime ujore. Në brendësi, Rrethi i Pukës përshkohet nga ujëderdhje të shumta, që burojnë prej vargmalesh dhe janë të ndërprerë me lugina të thella e qafa të ngushta. Në Malësinë e Pukës i gjen të gjitha brezat bimorë, që nga shkurret mesdhetare, dushqet, pyjet (e pishës, bredhit dhe ahut), e deri tek kullotat verore në lartësi. Shkurret dhe dushqet zhvillohen në zonat e ulëta, në lugina dhe kodra. Pyjet e pishës, bredhit dhe ahut gjenden në lartësitë mbi 800 m mbi nivelin e detit, në Krrab, Tërbun, Munellë dhe Kunorë–Dardhë. Në rrafshet e larta të maleve shtrihen livadhet dhe kullotat verore.

Bimësia në Malësinë e Pukës është e pasur dhe e larmishme. Në të rriten rreth 160 lloje drurësh. Më të përhapurit janë: pisha e zezë, bredhi i bardhë, ahu, lisi, shkoza, etj. Bimësia pyjore mbulon rreth 80% të shpërfaqjes së rrethit duke e bërë atë një nga zonat më të pasuara në Shqipëri. Pylli ka qenë e mbetet simbol për Pukën.

Gjithashtu, në pyjet e Pukës strehohet një faunë e pasur ku ndeshen ujku, dhelpra, lepuri, vjedulla, derri i egër, dhia e egër, ariu si dhe shpendë të tilla si thëllëza, pëllumbi i egër, gjeli i egër, etj.

Klima është me dimra të ftohtë dhe reshje të shumta (rreth 2020 mm në vit). Temperatura mesatare e të ftohtit është -3°C dhe e ulëta arrin deri në -24°C. Mesatarja e të nxehtit në verë arrin në +20°C. Më e larta arrin deri në +39°C. Në shumë zona, bora zgjat deri në prill.

Në Pukë ndodhen shumë monumente të natyrës si Akaciet e Migjenit, Pisha e Dardhës, Guri i Shenjtë, Gështenjat e Kokëdodës, Sofra e Lekës, Shpella e Kaurrit, Ujëvara e Kryeziut, etj. Në Shtojcën 1 është paraqitur lista e monumenteve të natyrës.

Infrastruktura rrugore në Rrethin e Pukës është e dobët. Nga 76 fshatra që ka rrethi, 10 prej tyre nuk kanë lidhje me rrugë automobilistike as në periudhën e verës. Shumica e komunave (Iballa, Fierza, Blerimi e Qelëza) bllokohen herë pas here nga reshjet e borës gjatë dimrit.

2.8.2. Ndarja administrative dhe popullsia

Nga pikëpamja administrative, Rrethi i Pukës ndahet në 2 Bashki--Pukë dhe Fushë-Arrëz--dhe 8 Komuna--Blerim, Fierzë, Gjegjan, Iballë, Qafë-Mali, Qelëz, Qerret dhe Rrape (Shih Figura 1). Popullsia jeton në 2 qytete dhe 76 fshatra. Puka përbëhet kryesisht nga fshatra të vegjël e të shpërndarë që formojnë brenda krahinës tre ndarje të mëdha gjeografike: Pukë; Iballë; Mahi (Spas). Brenda këtyre ndarjeve dallohen ndarje më të vogla si: Puka--Ana e Drinit, Ana e Udhës, Bregu i Guminës, Ana e Malit; Iballë--Brigjet, Fusha e Iballës dhe Rruga e Madhe; dhe Mahia/Spasi--Bregu i Srriqes dhe Brigjet e Dukagjinit. Me ndarjen administrative të vitit 1946, Spasi me përjashtim të Lajthizës dhe Ujit të Ftohtë ju dha Kukësit, ndërsa lugina e Fanit të Madh dhe Korthpula ju bashkua Pukës.

Popullsia e Pukës është e besimit katolik (afro 80%) dhe mysliman (rreth 20%). Komunitetet fetare kanë pasur gjithmonë fqinjësi të mirë dhe marrdhënie vëllazërore.

Figura 1. Ndarja administrative e rrethit të Pukës



Ne fillim të viteve 90-të, popullsia e Rrethit të Pukës ka qenë rreth 59.000 banorë. (Tabela 1 paraqet të dhëna për popullsinë sipas ndarjes administrative. Në Shtojcën 2 paraqitet në detaje popullsia e Rrethit

të Pukës sipas ndarjes administrative.) Aktualisht popullsia e Rrethit të Pukës është 33.145 banorë. Gjatë viteve të tranzicionit nga socializmi në demokraci, popullsia në rrethin e Pukës është reduktuar ndjeshëm sidomos si pasojë e migracionit drejt qyteteve të mëdha (Tiranë, Shkodër, Durrës) dhe jashtë vendit. Kryesisht ka migruar popullsia fshatare e Pukës, sidomos nga zonat e thella të Rrethit, e cila përballet me kushtet e vështira të jetesës deri në mbijetesë.

Tabela 1. Të dhëna për rrethin e Pukës sipas ndarjes administrative

NR.	Bashki dhe Komuna	Sipërfaqja (ha)	Nr. fshatrave	Nr. banorëve	Nr. familjeve
1	Bashkia Pukë	4,021	2	5,479	1,584
2	Bashkia Fushë Arrëz	3,106	3	5,084	1,208
3	Blerim	10,251	7	2,433	813
4	Fierzë	8,119	8	2,485	632
5	Gjegjan	16,461	10	5,006	1,280
6	Iballë	12,820	8	2,711	839
7	Qafë Mali	14,313	9	2,234	570
8	Qelëz	6,334	9	2,396	579
9	Qerret	23,071	12	3,308	949
10	Rrape	4,873	8	2,009	518
TOTALI		103,369	76	33,145	8,972

Në traditën e hershme, në Pukë kanë ekzistuar vetëm 4 njësi vendore të quajtura Lokalitete (Lokaliteti i Pukës, Fushë Arrëzit, Iballës dhe Gjeganit). Seicla prej tyre kishte një administratë të vogël, por shumë efektive. Pranë seicilit Lokalitet kishte edhe shërbimet përkatëse dhe inspektoriatet për arsimin, shëndetësinë, bujqësinë, veterinarinë, dezinfektimin dhe higjenën, taksat, etj. Secili lokalitet kishte afërsisht të njëjtat tradita kulturore dhe etnografike, kushte klimaterike e tokësore, dhe numër popullsie e sipërfaqe terreni. Kjo traditë u prish me krijimin e kooperativave bujqësore në vitin 1967.

Kooperativat bujqësore u prishën në vitet e para të pluralizmit. Sidoqoftë, ndarjet administrative të bazuara në ish-Këshillat e Bashkuar u ruajtën duke u shndërruar në Këshillat e Bashkuar Pluralist mbi bazën e të cilëve u krijuan edhe komunat dhe bashkitë e sotme. Sot Puka ka 10 Njesi të Qeverisjes Vendore, nga të cilat 2 janë bashki dhe 8 janë komuna. Krijimi i tyre ishte më shumë i bazuar në interesat e forcave politike se sa në ndonjë studim real dhe në nevojat e popullsisë. Kështu, u ngritën komuna të tilla si ajo e Qafë-Malit vetëm 2 km larg Bashkisë së Fushë Arrëzit apo Komuna e Rrapes dhe Lufit vetëm 10 km larg Bashkisë së Pukës.

Në Pukë sikurse në gjithë vendin, njësitë vendore kanë ka influencë të vogël në disa shërbime që ofrohen në territorin e tyre. Kështu arsimi dhe shëndetësia, megjithëse janë të organizuara mbi bazat e njësive vendore, kanë vartësi direkte nga Drejtoritë apo Zyrat përkatëse që janë në vartësi të ministrive

si dhe buxhet më vete (për shembull, qendrat shëndetësore). Shërbimet e bujqësisë (shërbimi i ekstensionit, shërbimi veterinar, kontrolli ushqimor, inspektoriat i higjenës, etj.) nuk kanë asnjë ndërvartësi me pushtetin lokal.

Megjithë përpjekjet e bëra si nga pushteti lokal, OJF-të, apo donatorë të ndryshëm, nuk ka një strategji zhvillimi afat-mesme apo afat-gjatë për të gjitha njësitë vendore të Rrethit të Pukës. Deri tani, vetëm Bashkitë Pukë dhe Fushë Arrëz kanë përfunduar strategjitë afat-mesme të zhvillimit ndërsa Komuna Luf-Qerret është në përfundim të saj. Komunitet e tjera nuk kanë as mundësitë financiare dhe as personelin e kualifikuar për të bërë një gjë të tillë. Ka komuna që ju mungojnë projektet apo nuk kanë identifikuar prioritetet e tyre për zhvillim afat-mesëm dhe afat-gjatë.

2.9. Arsimi në rrethin e Pukës

Arsimi parashkollor. Në shkallë rrethi funksionojnë 32 kopshte fëmijësh, nga këto 2 janë me ushqim (në qytetet Pukë dhe Fushë-Arrëz) dhe 30 janë në fshat. Janë regjistruar 731 fëmijë, nga këto 581 në fshat, në 45 grupe të fëmijëve, nga këto 32 të përzier dhe 7 përgatitor (eksperimental). Ka 57 edukatorë kopshti, me ngarkesë 12.8 fëmijë/edukator.

Arsimi 9–vjeçar. Rrethi i Pukës ka 31 shkolla 9-vjeçare përfshirë 17 shkolla qëndër, 14 shkolla vartëse me dy cikle dhe 32 shkolla me klasat 1-5 dhe 2 shkolla me cikël të lartë. Për vitin shkollor 2011-2012, janë regjistruar 3102 nxënës përfshirë 1502 nxënës në ciklin e ulët dhe 1600 nxënës në ciklin e lartë. Për arsye të numrit të nxënësve, shkollat janë me klasa teke dhe kolektive. Në shkallë rrethi janë 100 klasa kolektive, nga të cilat 69 në arsimin fillor dhe 31 në arsimin e mesëm të ulët. Niveli i nxënjes së dijeve në klasat kolektive lë shumë për të dëshiruar. Kjo provohet nga provimet shtetërore ku këto klasa kanë patur rezultate shumë të dobëta. Në arsimin fillor punojnë 112 mësues, nga të cilët 47 janë me universitet dhe 43 me arsim të mesëm. Raporti mësues-nxënës në ciklin e ulët është 12.4 dhe në ciklin e lartë është 17.32. Në arsimin e mesëm të ulët janë 135 mësues, nga të 122 cilët janë me shkollë të lartë (universitet) dhe 13 janë me arsim të mesëm.

Rrethi ka 2 *Qendra Kulturore të Fëmijëve* që funksionojnë në dy bashkitë Pukë dhe Fushë Arrëz me personel të plotësuar me mësues specialist. Në këto qendra funksionojnë rrethe të ndryshme me fëmijë të apasionuar pas muzikës, pikturës, punës me dru, kërcimit, etj.

Arsimi i mesëm. Në Pukë ka 7 shkolla të mesme, përfshirë 2 shkolla të mesme të përgjithshme në dy bashkitë e Rrethit (Pukë dhe Fushë Arrëz) dhe 5 shkolla të mesme të bashkuara në fshat. Arsimi i mesëm ka 966 nxënës, nga të cilët 337 në fshat. Çdo vit rregjistrohen në universitete mbi 60 % e nxënësve që mbarojnë shkollën e mesme. Në arsimin e mesëm bie në sy mungesa e arsimit të mesëm profesional dhe atij bujqësor. Ka 63 mësues në arsimin e mesëm dhe raporti mësues/nxënës është 15.5.

E gjithë veprimtaria e arsimit në rrethin e Pukës ndiqet dhe zbatohet nga Zyra Arsimore e Rrethit me 10 punonjës gjithsej. Në sektorin e arsimit në Rrethin e Pukës punojnë 458 punonjës, nga të cilët 10 janë punonjës të Zyrës Arsimore dhe 56 janë punonjës jo-arsimor. Nga 41 drejtues të institucioneve arsimore, 16 (ose 39 %) janë femra. Në Pukë nuk ka asnjë institucion arsimit privat.

Investimet. Në 2011 ka përfunduar shkolla Luf dhe është në ndërtim shkolla në Apripe. Janë në fillimet e rikonstruksionit shkolla 9-vjeçare Pukë, shkolla Gjegjan, shkolla Qelëz, etj. Këto investime realizohen me financimin nga buxheti i shtetit.

2.10. Kujdesi shëndetësor në Rrethin e Pukës

Shërbimet shëndetësore primar dhe sekondar në rrethin e Pukës janë publike. Drejtimi i veprimtarisë së institucioneve të shërbimit shëndetësor realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Shëndetit Publik. Përsa i përket infrastrukturës së *shërbimit sekondar*, Puka ka 1 spital me 90 shtretër me repartet kryesore përkatëse (pathologji, kirurgji, pediatri, obsteri-gjinekologji, terapi intensive, dhe urgjencë. Pranë sptalit funksionon poliklinika e specialisteve me kabinetin e sëmundjeve pulmonare, neurologjinë, pediatriinë, dhe kirurgjinë.

Shërbimi parësor përfshin repartet e higjenës dhe të epidemiologjisë që drejtohen dhe kontrollohen nga dy mjekë specialist, dhe 10 qendra shëndetësore, 2 prej të cilave në qytet dhe 8 në fshat, me një personel prej 13 mjekësh, 5 në qytet dhe 8 në fshat, dhe 156 mami-infermiere, prej të cilave 41 në qytete dhe 115 në fshat. Përsa i përket aktivitetit të shërbimit primar, sidomos të institucionit të mjekut të familjes, pikat më të dobëta të tij, veçanërisht në fshat, janë problemet e shëndetit të nënës e fëmijës. Mungesa e mjekëve në komunat përkatëse ka bërë që të punësohen mjekë që nuk jetojnë në atë zonë dhe për rrjedhojë edhe të mos jenë çdo ditë pranë banorëve të komunës apo zonës që mbulojnë. Po t'u shtosh këtyre edhe mundësinë e vogël të lëvizjes të mjekëve apo personelit tjetër shëndetësor nga një familje në tjetrën për shkak të largësisë së fshatrave dhe shtëpive nga njëra-tjetra rezulton një kujdes shëndetësor i pamjaftueshem i ofruar për banorët

Shërbimi farmaceutik funksionon me 3 farmaci, 2 prej të cilave të rrjetit të hapur, me kontratë me sigurimin e kujdesit shëndetësor.

2.11. Punësimi dhe mbrojtja sociale në Rrethin e Pukës

Në Pukë veprojnë 314 subjekte dhe institucione të ndryshme private dhe publike me 1980 punonjës (në këto shifra nuk janë përfshirë aktivitetet bujqësore që nuk janë të regjistruara si subjekte private). Sektori publik përfshin 42 subjekte apo institucione me 1318 punonjës, nga të cilat 31 janë subjekte buxhetore me 1021 punonjës dhe 11 janë subjekte jo-buxhetore me 297 punonjës. Sektori privat përfshin 272 subjekte, nga të cilat 230 janë persona fizik dhe 42 persona juridik. Në sektorin privat janë të punësuar 662 punonjës (252 punonjës tek personat fizik dhe 410 punonjës tek personat juridik.

Sipas gjinisë, në shkallë rrethi nga 1980 punonjës janë 981 meshkuj dhe 999 femra. Në sektorin publik mbizoteron numri i punonjësve femra (804 femra ndaj 514 meshkuj). Në profesione të tilla si ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues ka dy herë më shumë meshkuj sesa femra. Në profesionet e tjera si specialist, ndihmës specialist dhe punëtor ka më shumë femra. Në sektorin privat, ka më shumë të punësuar meshkuj (467 meshkuj dhe 195 femra). Diferenca më e theksuar është tek personat fizik (207 janë meshkuj dhe 45 femra) që janë kryesisht aktivitete shërbimesh si servise makinash, bojaxhi, elektroaut, mekanik, ndërtim, etj. Tabela 2 paraqet punësimin sipas sektorëve dhe gjinisë dhe Tabela 3 paraqet punësimin sipas profesioneve dhe gjinisë. Figura 1 paraqet punësimin sipas profesioneve në

sektorin publik. Kurse Tabela 4 dhe Figura 2 paraqesin punësimin sipas aktiviteteve dhe gjinisë në sektorin publik.

Tabela 2. Punësimi sipas sektorëve dhe gjinisë

Nr	Emertimi	Të punësuar gjithsej		Sipas gjinisë	
		Subjekte/in stitucione	Punonjës	Meshkuj	Femra
1	Aktivitete gjithsej	314	1980	981	999
2	Në sektorin publik	42	1318	514	804
2.1	Shtetërore buxhetore	31	1021	413	608
2.2	Shtetërore jo buxhetore	11	297	101	196
3	Në sektorin privat	272	662	467	195
3.1	Të regjistruar persona fizik	230	252	207	45
3.2	Të regj. persona juridike	42	410	260	150
3.2.1	Firma vendase	42	410	260	150
3.2.2	Firma të huaja	0	0	0	0


Burimi: Zyra e Punësimit Pukë

Tabela 3. Punësimi sipas profesioneve dhe përkatësisë gjinore në sektorin publik

Nr	Përshkrimi sipas profesioneve	Numri i punonjësve gjithsej	Sipas gjinisë	
			Femra	Meshkuj
1	Ligjvënës, nëpunës të lartë, drejtues	71	24	47
2	Specialistë	434	295	139
3	Teknikë dhe ndihmës specialist	447	311	136
4	Nëpunës të thjeshtë	84	31	53
5	Punëtorë	282	143	139
	Të punësuar gjithsej	1318	804	514

Burimi: Zyra e Punësimit Pukë

Figura 2. Paraqitja grafike e punësimit sipas profesioneve në sektorin publik



Burimi: Zyra e Punësimit Pukë


Sipas aktiviteteve ekonomike rezulton se së bashku arsimi dhe shëndetësia kanë 892 punonjës, nga 1318 që janë të punësuar ose 67.6 %. Po kështu, edhe numri i femrave të punësuar në këta sektorë është shumë më i lartë se sa i meshkujve, nga 892 punonjës 671 janë femra ose 75.2 %. Pamje krejt të kundërt vërejmë në sektorët e pyjeve dhe energjisë dhe ujit, ku nga 105 të punësuar janë vetëm 14 femra ose 13.3 %.

Tabela 4. Punësimi sipas aktiviteteve ekonomike dhe përkatësisë gjinore në sektorin publik

Nr	Përshkrimi sipas aktiviteteve	Nr.i punonjësve gjithsej	Sipas gjinisë	
			Femra	Meshkuj
1	Pyje	54	3	51
2	Sektori i energjisë dhe ujit	51	11	40
3	Transport, komunikacion	17	10	7
4	Arsim	461	330	131
5	Shëndetësi	431	341	90
6	Të tjera aktivitete	304	109	195
	Të punësuar gjithsej	1318	804	514

Burimi: Zyra e Punësimit Pukë

Figura 3. Punësimi sipas aktiviteteve ekonomike në sektorin publik



Burimi: Zyra e Punësimit Pukë


Pagat. Të dhëna për pagat ka vetëm për sektorin publik. Tabela 5 paraqet pagat mesatare sipas profesioneve në sektorin publik. Figura 3 paraqet pagat sipas profesioneve në sektorin publik.

Tabela 5. Paga mesatare sipas profesioneve në sektorin publik

Nr	Përshkrimi sipas grupeve të profesioneve	Nr. punonjesve	Paga mesatare leke
1	Ligjvënës, nëpunës të lartë, drejtues	71	77384
2	Specialist	434	49840
3	Teknikë dhe ndihmës specialist	447	39259
4	Nëpunës të thjeshtë	84	33416
5	Punëtorë	282	28959
	Gjithsej	1318	42221

Burimi: Zyra e Punësimit Pukë

Figura 4. Grafiku i pagave sipas profesioneve në sektorin publik



Burimi: Zyra e Punësimit Pukë

Papunësia. Sipas të dhënave zyrtare, në fund të vitit 2011 në rrethin e Pukës ishin të regjistruar 4267 pun-kërkues të papunë, ose 12.8 % e numrit të përgjithshëm të popullsisë, përfshirë 1890 femra dhe 2577 meshkuj. Nga ky numër, 2580 veta (ose 60.4 %) janë kryefamiljarë dhe 3230 persona janë të papunë afat-gjatë (mbi 3 vjet). Në 2011, janë shtuar 111 persona të papunë. Sipas arsimimit, 2679 të papunë (ose 62.7 %) janë me arsim të mesëm, 1548 janë me arsim 9-vjeçar, 30 me arsim fillor, dhe 7 me arsim universitar. Sipas grup-moshave, 3141 të papunë (ose 73.6 %) janë të moshës 30-50 vjeç, 401 ose 9.3 % të moshës mbi 50 vjeç, dhe 694 16.2 % të moshës 20-30 vjeç.

Ndihma sociale. Sipas të dhënave zyrtare të njësive vendore, rezultojnë ndihmë ekonomike 4086 familje nga 8972 familje që ka gjithsej rrethi, ose 45.5 % e tyre. Me pagesë papunësie janë 134 persona që kanë qene të punësuar për më shumë se një vit dhe kanë dalë të pa punë në vitin 2011 si rezultat i shkurtimeve apo reformave të ndryshme në sektorin publik.

2.12. Sektori i bujqësisë në Rrethin e Pukës

2.12.1. Vendi i bujqësisë, toka bujqësore dhe reforma e tokës, dhe administrimi publik i bujqësisë në Rrethin e Pukës

Megjithëse me sipërfaqe të kufizuar për frymë (450 m²), bujqësia përbën aktivitetin bazë për popullsinë e Rrethit të Pukës. Afërsisht 70 % e familjeve që jetojnë në fshat kanë si burim të vetëm jetese të ardhurat që sigurojnë nga toka bujqësore dhe blegtoria. Pjesa tjetër e popullsisë fshatare ka si burim të ardhurat nga emigracioni i pjesëtarëve të familjes.

Në masën 80%, prodhimi bujqësor dhe blegtoral përdoret për konsum të brendshëm. Shumë pak ky prodhim nxirret në treg. Analiza e treguesve të prodhimit bujqësor dhe blegtoral tregon se ato janë nën nivelin e potencialeve prodhuese që ka rrethi. Ekzistenca e zonave dhe mikrozonave të veçanta klimatike, zgjidhja përfundimtare e problemeve të pronësisë mbi tokën, dhe ekzistenca e fuqisë punëtore relativisht e lirë janë premisa që garantojnë efektivitetet të investimeve që mund të bëhen në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë në Rrethin e Pukës.


Para viteve 90-të, e gjithë sipërfaqja e tokës ishte në pronësi të shtetit. Shteti u kishte dhënë anëtarëve të ish-kooperativave bujqësore deri në 1000 m² (një dynym) tokë në përdorim për ta mbjellë për nevojat e familjes. Pas viteve 90-të, në Rrethin e Pukës, praktikisht Ligji 7501 që parashikonte ndarjen e tokës bujqësore për frymë nuk është zbatuar--secili mori ish-tokën e tij. Sipërfaqet e tjera si pyjet, kullotat, sipërfaqet ujore, rrugt, etj. mbetën pronë shtetërore. Vitet e fundit, ka filluar kalimi në pronësi të komunave/bashkive dhe në pronësi private edhe i sipërfaqeve pyjore dhe kullotave. Tabela 6 dhe Figura 4 paraqesin ndarjen e tokës sipas destinacionit/pronësisë.

Tabela 6. Ndarja e tokës sipas destinacionit/pronësisë

Lloji i Tokës	Private	Shtetërore	Totali
Bujqësore	95.9%	4.1%	100.0%
Truall	99.8%	0.2%	100.0%
Livadhe	99.3%	0.7%	100.0%
Pyje	0.0%	100.0%	100.0%
Kullota	85.6%	14.4%	100.0%
Jo-produktive	81.4%	18.6%	100.0%
Totali	41.1%	58.9%	100.0%

Burimi: Zyra e Bjqësisë Pukë

Figura 5. Ndarja e tokës sipas pronësisë



Burimi: Zyra e Bujqësisë Pukë

Nga 103,369 ha që është sipërfaqja totale e Rrethit të Pukës, vetëm 5,165 ha janë tokë bujqësore ose 4.99 % e saj. Por, edhe nga kjo sipërfaqe totale e tokës bujqësore, vetëm 2,665 ha janë nën kulturë (që mbillen) pasi mbi 2,500 ha toka të përfituara nga shpyllëzimet e bëra në vitet 1967-1989 kanë degraduar dhe janë kthyer në toka jo-produktive të cilat nuk mbillen dhe vazhdimisht po dëmtohen nga erozioni masiv. Kjo sipërfaqe toke bujqësore jo-produktive, me disa masa mbrojtëse ndaj erozionit, mund të përdoret për kullotje (rreth 1,200 ha) ose mund të ripyllëzohet dhe të kthehet në identitet (1,300 ha).

Ujitja. Burimet ujore në rreth janë të mjaftueshme që e gjithë sipërfaqja e tokës bujqësore të vihet nën ujë. Sidoqoftë, rreth 50% e fondit të tokës bujqësore është mbi ujë, 30% e sipërfaqës mbillet në kushtet e një ujitje të kufizuar dhe vetëm 20% e sipërfaqes është në vaditje të plotë. Rikonstruksioni i rrjetit ekzistues ujitës është i nevojshëm. Prej shumë vitesh, nuk është bërë asnjë investim për mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e veprave ujitëse.

Fermat bujqësore. Në shkallë rrethi, nga 6,957 familje që jetojnë në fshat, 5,434 prej tyre merren me bujqësi e blegtori. Edhe ato familje rurale që nuk merren direkt me bujqësi apo blegtori si dhe shumë familje që jetojnë në dy qytetet e Pukës dhe Fushë Arrëzit kanë aktivitete ndihmëse bujqësore dhe blegtorale (mbajnë lopë, shpendë, bletë, kujdesen për vreshta, pemëtore, mbjellin sasi të kufizuara perimesh, etj.). Madhësia e fermave bujqësore është zakonisht 2000-3000 m² për familje (2-3 dynym) ose mesatarisht 450 m² tokë për frymë.

Në Rrethin Pukës sot ka Zyrë të Bujqësisë me një personel prej nëntë punonjësish përfshirë Përgjegjësi i Zyrës, 3 inspektorë veterinar, 4 ekstensionist (Qendra e Informacionit Bujqësor--QIB), dhe një person në statistikë.

2.12.2. Prodhimi bujqësor

Kulturat kryesore që rriten në Rrethin e Pukës janë misri, gruri, fasulja, patatja, perimet, pemët, rrushi, etj. Tabela 7 paraqet sipërfaqen e tokës bujqësore sipas kulturave të mbjella. Ndërsa Tabela 8 paraqet sipërfaqen, rendimentin dhe prodhimin sipas kulturave bujqësore.

Tabela 7. Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas kulturave që mbillen

Nr	Kulturave që mbillen	Sipërfaqja ha
1	Misër	1228
2	Grurë	10
3	Fasule	50
4	Patate	124
5	Perime	220
6	Foragjere	570
7	Pemëtari	253
8	Vreshta	30
9	Të tjera (arra dhe geshtenja)	180
10	Shuma nën kulturë	2665
11	Toka jo-produktive	2500
12	Totali tokë bujqësore	5165

Burimi: Zyra e Bujqësisë Pukë

Misri. Pothuajse gjysma e tokës nën kulturë në Rrethin e Pukës mbillet me misër. Kjo lidhet si me traditën--misri është përdorur për bukë nga popullsia lokale—ashtu dhe me nevojat që kanë fermerët për ushqimin e gjësë së gjallë, kryesisht derrat dhe shpendët. Megjithëse rendimenti në misër është i ulët--vetëm 38.4 kv/ha--dhe kostoja e prodhimit shpesh herë më lartë se vlera e prodhimit, fermerët pukjanë vazhdojnë të kultivojnë misrin. Një arsye kryesore është se shumica e tyre nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të blerë koncentrate për derrat, shpendët dhe bagëtitë e tjera. Të gjitha shërbimet në misër i kryejnë vetë, me anëtarët e familjes. Nga një numër i konsiderueshëm familjesh, misri gjithashtu mbillet edhe për konsumin e bukës së misrit bazuar si në traditën apo edhe në pamundësinë për të konsumuar bukën e grurit. Në përgjithësi, fermerët mbjellin edhe fasule bashkëshoqëruese në parcelat e misrit, e cila është një ushqim tradicional për periudhën e dimrit, por edhe gjatë gjithë vitit. Në këtë mënyrë rritet edhe rentabiliteti i mbjelljes së parcelave me misër. Kashta e misrit përdoret si ushqim i thatë për blegtorinë në periudhën e dimrit.

Gruri. Sipërfaqja e mbjellë me grurë është shumë e vogël, vetëm 10 ha në të gjithë Rrethin e Pukës. Rendimenti i grurit është vetëm 21 kv/ha. Para viteve 90-të, në Rrethin e Pukës mbilleshin mbi 1,000 ha me grurë dhe thekër. Thekra mbillej kryesisht në tokat e reja dhe të varfëra. Sot, këto toka janë jo-produktive dhe nuk mbillen fare. Arsyet e reduktimit të sipërfaqeve të mbjella me grurë janë edhe mungesa e mekanizimit, sidomos e makinave korrëse dhe shirëse të grurit

Fasulja. Në Rrethin e Pukës, me fasule direkte mbillen rreth 50 ha. Rendimenti i fasules është rreth 10.64 kv/ha (prodhimi është rreth 532 kv). Fermerët pukjanë mbjellin fasule bashkëshoqëruese me misrin. Rendimenti në këtë rast është 1.5-2 kv/ha. Kështu që prodhimi në total i fasules i kalon 2000 kv në shkallë rrethi. Kjo sasi kryesisht konsumohet brenda rrethit nga familjet fermere të fshatit ose shitet në tregjet e dy qyteteve Pukë dhe Fushë Arrëz. Prodhimi lokal i fasules është i pamjaftueshëm për furnizimin e dy qyteteve.

Patatet. Rrethi i Pukës ka traditë në prodhimin e patates, falë edhe kushteve të përshtatshme klimaterike dhe tokësore. Pothuajse të gjitha komunat kanë fshatra që shtrihen mbi 500 m mbi nivelin e detit, të cilat janë të përshtatshme për këtë kulturë. Në shkallë rrethi mbillen 124 ha patate dhe merren 21,978 kv, me rendiment prej 177.2 kv/ha. Patatja është një kulturë me efektivitet të lartë ekonomik. Prodhimi i patates kryesisht konsumohet brenda rrethit. Ai nuk i mbulon kërkesat e tregut në dy qytetet

e Pukës dhe Fushë Arrezit. Rendimenti i larte, efektiviteti i prodhimit, dhe kërkesa e tregut janë premisë për shtimin e sipërfaqeve dhe të prodhimit të patates në të ardhmen në Rrethin e Pukës.

Perimet. Në shkallë rrethi mbillen 220 ha perime dhe prodhohen 32,815 kv, me një rendiment prej 149 kv/ha. Nga perimet që konsumohen në familje, vendin kryesor e zë lakra që tradicionalisht gatuhet gjatë periudhës së dimrit dhe përdoret edhe si turshi. Perime të tjera që mbillen janë domatet, trangujt, specat, qepët, etj. Vitet e fundit kanë filluar të kultivohen edhe bishtajat, patëllixhanat, kungujt, dhe karrotat që janë shtuar në kulturën e gatimit. Pothuajse e gjithë sasia e perimeve mbillet për nevojat e familjeve fermere. Vetëm pak familje, kryesisht në fshatrat rreth qyteteve, mbjellin sasi më të mëdha se nevojat e familjes, duke e nxjerrë prodhimin në treg. Prodhimi për treg është i kufizuar edhe për shkak të largësisë me tregun, infrastrukturës së dobët rrugore, kushteve të transportit, mungesës së ambalazhimit të përshtatshëm dhe kushteve jo të mira për magazinim. Konkurrenca e prodhimit dhe kushtet shumë më të mira klimateriko-tokësore që kanë rrethet fqinjë si Shkodra apo Lezha bëjnë që të ulet interesi i fermerëve pukjanë për të mbjellë perime për treg.

Pemëtaria. Sot në Rrethin e Pukës janë 253 ha të mbjella me pemë. Në shkallë rrethi numërohen 186,824 rrënjë pemë (duke përfshirë edhe ato që nuk janë mbjellë në blloqe) nga të cilat në prodhim janë 67,328 rrënjë. Sipas statistikave, prodhimi vjetor për vitin 2011 ka qenë 14.762 kv. Rendimenti i ulët prej rreth 22 kg/rrënjë shpjegohet me faktin se një pjesë e mirë e pemëve janë të sapo futura në prodhim. Për shkak të mungesës së tokës për kultivimin e bimëve të arave, Rrethi i Pukës e ka traditë mbjelljen e pemëve rreth shtëpive, në fundet e arave dhe mezhdave, në oborre dhe në toka të tjera jo-bujqësore. Si pemë të veçuara mbillen qershia, kumbulla, molla, arra dhe gështenja (në brigjet e përrenjëve), mani, dardha dhe pjeshka. Mbjellja e pemëve në blloqe filloi të aplikohet pas vitit 1967, me kolektivizimin e bujqësisë. Por, edhe në këtë periudhë pemëtaria mbillej në toka jo-pjellore. U krijuan disa blloqe pemëtoresh në Qerret, Gjegjan, Iballë, Dardhë, Fierzë, Kryezi, Qelëz, Blerim, etj. Gjate viteve të para të tranzicionit, këto blloqe u dëmtuan pothuajse plotësisht. Nga viti 1995, falë edhe politikave stimuluese të ndjekura nga Qeveria Shqiptare dhe donatorë të ndryshëm, janë mbjellë pemë në blloqe massive. Gjatë periudhës 2001-2009, vetëm Shoqata Agropuka ka subvencionuar mbjelljen e mbi 17,000 pemëve frutore. Sot në Pukë janë 72 ferma bujqësore me sipërfaqe mbi 5 dynym për fermë që kanë aktivitet kryesor pemëtarinë dhe vreshtarinë që kanë destinacion edhe tregun.

Vreshtaria. Puka ka traditë të hershme në vreshtari, në kultivimin e pjergullave në fundet e arave dhe kopshteve ose në krijimin e tendave të rrushit në oborre. Lloji kryesor dhe më i përhapur ka qenë rrushi amerikan (ose rrushi me erë apo rrush vajguri) i cili është rezistent dhe i përshtatet kushteve klimaterike edhe në zona të larta dhe ka një prodhimtari relativisht të lartë. Në Berishë, Gjegjan, Qelëz, Arst-Miliska, Fierzë, etj., ka patur edhe kultivarë të tjerë shumë të mirë si për tavolinë edhe për prodhim vere dhe rakie. Gjatë viteve të ish-kooperativave bujqësore, interesimi për vreshtarinë ishte i ulët. Sidoqoftë, u krijuan disa blloqe me vreshta në Qelëz, Fierzë, Dardhë, Gjegjan, etj., të cilat u shkatërruan në vitet e para të tranzicionit. Pas viteve 2000, falë edhe subvencioneve të Qeverisë dhe donatorëve ka filluar mbjellja e vreshtave në plantacione. Vetëm Shoqata Agropuka ka subvencionuar mbjelljen e mbi 22,000 rrenjë hardhie të kontrolluara dhe të çertifikuara. Nëpërmjet Shërbimit të saj Këshillimor, Shoqata Agropuka ka bërë trajnime e kualifikime të specialistëve dhe fermerëve. Sot, në shkallë rrethi janë 30 ha vreshta me rreth 173,154 rrenjë hardhi. Sipas statistikave rezulton se 79% e prodhimit në vreshtari përdoret për të plotësuar nevojat e familjes (përfshirë edhe përpunimin në verë dhe raki) dhe vetem 21 % e prodhimit shkon në treg, kryesisht i freskët. Më suksesshme dhe fitimprurëse për fermerët ka qenë tregëtimi i varieteteve autoktone të rrushit për tavolinë.

Tabela 8. Sipërfaqet, rendimenti dhe prodhimi sipas kulturave bujqësore

Nr	Kulturat e mbjella	Sipërfaqja e mbjellë Ha	Rendimenti Kv/ha	Prodhimi Kv
1	Misër	1228	38.4	47173
2	Grurë	10	21	210
3	Fasule	50		532
4	Patate	124	177.2	21978
5	Perime	220	149	32815
6	Pemëtari (në prodhim)	67328 rrenjë	22 kg/rrenjë	14762
7	Vreshtari	30	140	4200
8	Foragjere	570	160.9	91716

Burimi: Zyra e Bujqësisë Pukë

2.13. Sektori i blegtorisë

2.6.1. Tradita në blegtori, llojet e kafshëve që mbarështohen, dhe madhësia e fermave blegtorale

Rrethi i Pukës ka traditë të hershme në mbarështimin e blegtorisë (të imtave, gjedhit, derrit, shpendëve, kuajve, dhe bletëve). Pozicioni gjeografik kodrinor-malor i Pukës ka favorizuar blegtorinë. Puka ka traditë edhe në përpunimin shtëpiak të produkteve blegtorale: mishi i derrit, lopës, të imtave bëhet pastërma; të imëtat bëhen ferlik për raste festash; qumështi përpunohet në kushte shtëpie (mpiksja e djathit me shtile ose mullza, tundja dhe prodhimi i gjalpit dhe dhallës, përgatitja e kumshtit, etj.); leshi përpunohej për prodhimin e veshjeve dimërore dhe popullore dhe të sixhadeve e qylimave; lekurët e kafshëve janë përpunuar për të prodhuar vegla muzikore (daulle, tarabuk, etj.) por edhe për opinga, postiqe (shtroja dysHEMEJE) apo veshje (tipe gunash) për burra e gra, sidomos për barinjtë.


Në Rrethin e Pukës mbarështohen të gjitha llojet e kafshëve shtëpiake si gjedhë, të leshta, të dhirta, njëthundrakë, shpendë, bletë, lepuj, etj. Kushtet klimaterike dhe terreni i thyer favorizojnë më shumë mbarështimin e të dhirtave dhe bletarinë. Tabela 9 dhe Figura 5 paraqesin blegtorinë sipas tipologjisë së kafshëve.

Tabela 9. Blegtoria sipas tipologjisë së kafshëve

Lloji	Krerë	Nr mesat. i krerëve/komunë	Nr. mesatar i krerëve/ha të sipërfaqes së kullotave	Nr. mesatar i krerëve/bërthamë familjare	Nr. mesatar i krerëve/njësi prodhuese bujqësore
Gjedhë	9,569	956	0.78	1.07	2.91
Të imta	38,292	3,829	3.12	4.27	11.66
Derra	8,112	811	0.66	0.90	2.47
Njëthund.	1,127	112	0.09	0.13	0.34
Shpendë	60,128	4,897	4.90	6.70	18.31
Totali	117,228	11,720	9.5	13.07	35.71

Burimi: Zyra e Bujqësisë Pukë

Figura 6. Blegtoria sipas tipologjisë së kafshëve



Burimi: Zyra e Bujqësisë Pukë

Në përgjithësi, në Rrethin e Pukës madhësia e fermave i përgjigjet plotësimin të nevojave kryesisht familjare dhe pak ato të tregut. Edhe ato ferma të cilat kanë një numër të konsiderueshëm krerësh të blegtorisë, janë të prirura në sistemin e mbarështimit ekstensiv dhe jo efektiv--shtim të rendimentit për krerë. Rritja efektive pengohet nga kryqëzimet e pa kontrolluara (imbriding), racat, të ushqyerit, sistemi i mbarështimit, etj. Zmadhimi i fermave në drejtim të rritjes së numrit të krerëve të mbarështuar shoqërohet me rritje të prodhimeve blegtorale dhe, për rrjedhojë, rritje të të ardhurave të ekonomive familjare. Vitet e fundit, vërehet një rritje e numrit të fermerëve që kanë një numër të konsiderueshëm të gjësë së gjallë si në të imëta ,gjedhë, derra, shpendë dhe bletë. Tabela 10 paraqet nmrin e fermave që kanë mbi 50 krerë të imëta.

Tabela 10. Numri i fermave me mbi 50 krerë të imta

Nr	Komuna/Bashki	Të leshta		Të dhirta	
		Tufa mbi 50 krerë	Tufa mbi 100 krerë	Tufa mbi 50 krerë	Tufa mbi 100 krerë
1	Komuna Qelëz	-	-	18	3
2	Komuna Rrape	-	-	6	3
3	Komuna Qafë-Mali	-	-	4	1
4	Komuna Gjegjan	1	-	7	-
5	Komuna Blerim	1	2	6	2
6	Komuna Iballë	1	-	5	1
7	Komuna Fierzë	-	-	3	-
8	Bashkia Pukë	-	-	7	-
9	Bashkia Fushë-Arrëz	-	-	1	1
10	Komuna Luf-Qerret	1	-	10	4
	Totali	4	2	67	15

Burimi: Zyra e Bujqësisë Pukë

Si shihet edhe nga tabela e mësipërme, në shkallë rrethi janë vetëm 88 ferma me mbi 50 krerë bagëti të imëta dhe vetëm 17 ferma me 100 krerë të cilat kanë destinacion edhe tregun, kanë fuqi punëtore (1 blegtor mund të kujdeset për rreth 70 krerë bagëti të imëta) dhe, për rjedhoje, kanë edhe një farë rentabiliteti ekonomik. Fermat e tjera që kanë më pak se 50 krerë prodhojnë kryesisht për nevojat e familjes dhe në treg shesin vetëm tepricat. Duke qenë se tregu lokal ka nevojë për produkte blegtorale dhe ato të Pukës janë më të kërkuara, duhet të punohet me fermerët për të shtuar numrin e krerëve dhe për t'i bërë fermat blegtorale fitimprurëse.

Gjedhi. Ndikuar nga kushtet e vështira të Rrethit të Pukës, janë vetëm 5 ferma me mbi 10 krerë lopë qumështi, nga të cilat 2 në Bashkinë Pukë, 2 në Komunën Luf-Qerret dhe 1 në Komunën Fierzë. Ata shesin qumësht të freskët në qytetin e Pukës dhe qytezën e Hidrocentralit të Fierzës. Ideja e mbajtjes së viçave për majmëri mund të nxitet e zhvillohet pasi kushtet janë të përshtatshme (ka kullota verore të bollshme) dhe tregu ka kërkesa të vazhdueshme për mish të freskët.

Bletaria. Ka një shtim të ndjeshëm të numrit të familjeve të bletëve në këto 20 vitet e fundit. Nga vetëm 800 familje (zgjoje) bletësh në vitet 90-të, sot janë rreth 6000 familje bletësh në të gjithë Rrethin e Pukës. Edhe madhësia e fermës është rritur ndjeshëm: Nga 10 zgjoje bletësh për fermë në vitet 90-të, sot në shkallë rrethi janë 39 parqe bletësh me mbi 50 zgjoje (shih Tabelën 11), nga të cilat 10 ferma mbarështojnë mbi 100 familje (zgjoje) bletësh.

2.6.2. Prodhimi blegtoral dhe destinacioni i tij

Blegtoria jep 60 % të prodhimit bujqësor-blegtoral në Rrethin e Pukës. Tabela 12 paraqet sasinë e prodhimeve blegtorale si qumështi, leshi, vezët, mishi, dhe mjalti në Rrethin e Pukës. Megjithëse të krijuhet përshtypja se ka një prodhim të bollshëm produktesh blegtorale, në fakt rendimenti i tyre është ulët. Kështu, rendimenti mesatar i qumështit për lopë është 1,063 litra në vit (bashkë me qumështin që konsumojnë viçat) që është pothuajse sa rendimenti i një dhie race. Edhe rendimenti i qumështit nga bagëtitë e imëta është i ulët--39 litra qumësht për dele dhe 90 litra qumësht për dhi (duke përfshirë edhe atë që konsumohet nga qingjat dhe kecat).

Tabela 11. Numri i fermave me mbi 50 zgjoje bletësh

Nr	Komuna/Bashki	Numri i familjeve të bleteve	
		mbi 50 zgjoje	mbi 100 zgjoje
1	Komuna Qelëz	4	1
2	Komuna Rrape	2	2
3	Komuna Qafë-Mali	1	1
4	Komuna Gjegjan	5	-
5	Komuna Blerim	4	2
6	Komuna Iballë	3	1
7	Komuna Fierzë	3	1
8	Bashkia Pukë	3	2
9	Bashkia Fushë-Arrëz	-	-
10	Komuna Luf-Qerret	4	-
	Totali	29	10

Burimi: Zyra e Bujqësisë Pukë

Tabela 12. Prodhimet blegtorale

Nr	Komuna /Bashki	Qumësht Lope ton	Qumësht dele ton	Qumësht Dhie ton	Lesh dele ton	Vezë 000 kokrra	Mish ton	Mjaltë ton
1	Komuna Qelëz	1056	22.4	485.5	0.4	459	150	6.4
2	Komuna Rrape	616	15.2	162	0.2	221	17	5.5
3	Komuna Qafë-Mali	616	23.5	204.7	0.4	441	60	8.1
4	Komuna Gjegjan	792	60.2	329.4	1.0	461	160	12.9
5	Komuna Blerim	572	20.1	75.6	0.3	357	45	9.2
6	Komuna Iballë	781	23.7	283.5	0.4	210	68	7.6
7	Komuna Fierzë	561	11.3	88.2	0.2	212	41	2.7
8	Bashkia Pukë	418	12,8	54.8	0.2	383	21	13.6
9	Bashkia Fushë-Arrëz	429	12.4	38.7	0.2	315	59	0.9
10	Komuna Luf-Qerret	1232	69.6	309.5	1.2	777	162	12.1
	Totali	7073	271.2	2031.9	4.5	3836	783	79
	Rendimenti	1063 kg/kr	39 kg/kr	90 kg/kr		89 kok/kr		13 kg/zgj

Burimi: Zyra e Bujqësisë Pukë

Produktet dhe nënproduktet blegtorale plotësojnë një pjesë të madhe të nevojave ushqimore të popullsisë në Pukë. Rreth 80% e prodhimeve blegtorale konsumohen për nevojat familjare dhe pjesa tjetër nxirret në treg. Produktet dhe nënproduktet blegtorale duhet të plotësojnë disa kushte optimal për të dalë në treg si freskia, pastërtia mikrobike e bakteriale, pastërtia nga mbetjet e ndryshme kimike, ambalazhimi, etiketimi dhe çertifikimi, etj. që shpesh nuk plotësohen. Një rol të rëndësishëm në tregëtimin e produkteve dhe nënprodukteve blegtorale luan infrastruktura--rruga automobilistike, afërsia me tregun, etj. Në Pukë, numri i baxhove ku mund të bëhej grumbullimi i sigurt dhe i çertifikuar i qumështit është i kufizuar.

Prodhimi dhe tregëtimi i mjaltit luan një rol të rëndësishëm në të ardhurat e familjeve fermere. Numri i koshereve me bletë dhe prodhimi i mjaltit është rritur mbi 5 herë krahasuar me vitin 1990. Shoqata "AGROPUKA" ka luajtur një rol të rëndësishëm në dhënien e asistencës shkencore nga specialistë të kësaj fushe për mbarështuesit e bletëve si dhe për grumbullimin, ambalazhimin, etiketimin dhe shitjen e mjaltit. Vit pas viti, interesimi i fermerëve për mbarështimin e bletëve është rritur.

Tregëtimi i mishit nga fermat bëhet kryesisht peshë e gjallë tek tregëtarët e mishi, të cilët shkojnë personalisht në shtëpitë e fermerëve për të blerë sidomos vica dhe të imëta (sidomos keca e qingja). Me pak tregëtohen pulat dhe derrat të cilat përdoren më shumë për konsum familjar. Problemet në tregëtimin e mishit lidhen me mungesën e traditës për të organizuar ditët e tregut të gjësë së gjallë dhe infrastrukturës rrugore të dobët. Ka dy thertore në qytetet Pukë dhe Fushë Arrëz. Gjendja e tyre, sidomos në drejtim të kushteve higjeno-sanitare, lë shumë për të dëshiruar. Në fshatra, zakonisht kafshët theren në rrugë, oborr, stallë, etj., pa u kontrolluar para dhe pas therjes nga mjeku veterinar.

Mbledhja dhe përpunimi i produkteve blegtorale. Rrethi i Pukës nuk ka asnjë baxho të përpunimit të qumështit. Përpunimi i produkteve blegtorale bëhet kryesisht në kushtet e familjes. Familjet që kanë një numër të konsiderueshëm bagëtish të imëta dhe lopë, ose e shesin qumështin të freskët me shishe plastike tek klientët familjarë në qytet, ose e bëjnë djathë të cilin e shesin në treg apo tek dyqanet e

qytetit. Disa nënprodukte si hirra, gjiza, gjalpi, etj. humbasin duke ulur ndjeshëm efektivitetin e punës së tyre.

Ushqimi për blegtorinë. Ushqimi për blegtorinë përbëhet kryesisht nga foragjeret, kashta e thatë e misrit dhe gjethet e thata të lisit si ushqimi bazë për periudhën e dimrit, dhe kullotja në natyrë në periudhën e verës. Në shkallë rrethi, në vitin 2011 janë mbjellë 570 ha dhe janë prodhuar 91716 kv foragjere me një rendiment mesatar prej 161 kv/ha. Vendin kryesor në kulturat foragjere e zënë livadhet me bar, shpesh herë të pakultivuara dhe mbi ujë ku merret vetëm një kositje dhe jonxha e cila mbillet pothuajse nga çdo familje, por në sasi të kufizuar për shkak të mungesës së tokës. Kultura të tjera foragjere janë hasëçlle, lakër foragjere, panxhar, etj.

2.6.3. Matrikullimi dhe çertifikimi i bagëtive dhe luftimi i sëmundjeve tek bagëtisë

Në fund të vitit 2008, në Rrethin e Pukës filloi matrikullimi i gjedhit. U matrikulluan rreth 9,569 krerë dhe procesi vazhdon me brezat e rinj. Në fund të vitit 2011 filloi dhe matrikullimi i të imëtave. Një pjesë e tyre janë matrikulluar dhe procesi vazhdon.

Në Pukë, është bërë një punë e kujdesshme për studimin e gjendjes epizotike duke hartuar çdo vit hartën epizotike, gjurmimet, depistimet dhe planin për shëndetësimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive dhe parazitare. Plani i masave profilaktike për çdo rreth hartohet nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK), Sektori i Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve. Shpërndarja e këtyre masave bëhet duke u bazuar në hartën epizotike të hartuar më parë në bazë.

Gjurmimi dhe vaksinimi për sëmundje të tilla si bruceloza në gjedh dhe të imëta, murtaja klasike e derrave, TBC në gjedh, dhe plasja në të imëta dhe gjedh subvencionohen nga buxheti i shtetit dhe realizohen nga operatorët veterinarë të kontraktuar në Drejtorinë Rajonale Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (DRUMK), Seksioni Veterinar. Gjatë vitit 2012, me ndihmën e Projektit “PAZA” të Bashkimit Evropian, do të bëhet vaksinimi i të gjitha të imëtave kundër brucelozës (bazuar në Ligjin nr. 10465 dt. 29. 09. 2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” dhe strategjinë e luftimit të sëmundjes së brucelozës/melitensis në bagëtisë e imëta). Për disa sëmundje tek kafshët si fruthi në derra, koksidioza, pseudopesti në shpend, fashiozoza në gjedh e të imta, agalaksia në të imta, varroatoza, pestat, nozeomatoza në bletë, etj., vaksinimi dhe shëndetësimi duhet të bëhet nga vetë fermeri sipas këshillave të mjekut veterinar sepse këto sëmundje nuk subvencionohen nga shteti. Problemet kryesore në këtë drejtim janë: Mos-shëndetësimi i kafshëve nga fermerët për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe mungesës së njohurive mbi këto sëmundje; Mos-funksionimi i laboratorit veterinar në rreth (për një analizë të thjeshtë, p.sh. mastitë, mostrat duhet të dërgohen në laboratorin rajonal të Shkodrës); Mungesa në strukturat e bashkive dhe komunave të mjekëve veterinarë apo specialistëve të blegtorisë dhe shërbimit veterinar privat (në Pukë ka vetëm 2 farmaci veterinare në qytetin e Pukës me nga një specialist të punësuar me kohë të pjesëshme).

2.14. Mekanizimi dhe inputet bujqësore

2.7.1. Mekanizimi i bujqësisë në Rrethin e Pukës

Niveli i mekanizimit në bujqësi në Rrethin e Pukës është shumë i ulët. Sot, me mjete mekanike punohen rreth 560 ha tokë, ose 21 % e tokës nën kulturë duke shënuar një ulje të ndjeshme krahasuar me vitin 1990 kur punoheshin me mjete mekanike mbi 4000 ha tokë. Gjithsejt, në shkallë rrethi janë 24 makineri bujqësore përfshirë 20 traktorë me goma, 2 motokorrëse bari dhe 2 freza. Nga 24 makineri bujqësore, 8 prej tyre (ose 33 %) janë subvencionuar nga AGROPUKA. Të tjerat janë investime të fermerëve. Makineritë bujqësore që disponon Rrethi i Pukës janë të përqëndruara në Qerret, Gjegjan, Qelëz, Pukë, Iballë, Blerim, Gojan, dhe Fushë Arrëz ku dhe mundësitë e përdorimit të tyre janë më të mëdha për shkak të sipërfaqes relativisht të madhe dhe relievit të sheshtë. Makinat bujqësore zotërohen kryesisht nga fermerët që kanë më shumë toke, të cilët punojnë tokën e tyre dhe të fermerëve të tjerë kundrejt pagesës për njësi sipërfaqeje. Çmimet për kryerjen e proceseve të mekanizuara janë të larta dhe në përgjithësi të papërballueshme nga fermerët e thjeshtë. Në këto kushte, fermerët janë të detyruar ta punojnë tokën me kafshë pune ose me krahë që ka çuar në rendimente të ulëta. Shpesh, toka është lënë e papunuar ose është shndërruar në livadhe e kullota për bagetinë.

Ulja e niveli të mekanizimit në bujqësi lidhet me disa faktorë:

- a. Ndarja e tokës së kooperativave bujqësore dhe ish-Ndërmarrjes Bujqësore për familjet fshatare solli copëzimin e tokës në ngastra të vogla të cilat edhe u rrethuan nga poseduesit e tyre duke vështirësuar futjen e mjeteve mekanike.
- b. Mjetet mekanike të ish kooperativave bujqësore, ish Ndërmarrjes Bujqësore (NB) dhe ish Stacionit të Makinave dhe Traktorëve (SMT) nuk u administruan siç duhet, por u morën me forcë dhe në përgjithësi levizën në zonat fushore të vendit ku përdorimi i tyre mund të ishte më fitimprurës.
- c. Në Pukë, fermat bujqësore janë në përgjithësi të vogla dhe për pasojë fermerët pukjanë nuk kanë mundësi të blejnë mjetet e kushtueshme mekanike. Nga ana tjetër, mundësitë e fermerëve për të paguar punimet e mekanizuara janë të pakta. Kostoja e lartë për karburantin, mirëmbajtjen dhe riparimin e mekanikës bujqësore ka ndikuar në përdorimin e pakët të saj.
- d. Edhe ato pak mjete që kanë hyrë në Pukë kryesisht janë të përdorura dhe shpesh të dala jashtë përdorimit në vendet e origjinës. Pjesët e ndërrimit për ta nuk gjenden lehtë dhe janë të kushtueshme.

Proceset e tjera gjithashtu nuk janë në nivelin e duhur. Trajtimet kimike bëhen zakonisht me mjete të thjeshta (pompa shpine apo mjete të tjera rrethore) të cilat nuk realizojnë trajtime me cilësi. Proceset e korrjes dhe manipulimit të bazës ushqimore për blegtorinë kryhen me mjete të thjeshta (kosa, drapër, etj.). Sot, asnjë fermë në Pukë nuk prodhon silazh. Përpunimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale kryhet në kushtet e shtëpisë duke dhënë produkte me cilësi të dobët, larg standarteve që kërkon tregu, duke mos realizuar dot të ardhura për fermerët. Këto faktorë kanë ndikuar në uljen e rendimentit dhe prodhimit bujqësor dhe blegtoral.

Transporti i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, i cili zë një volum të madh në punimet bujqësore, kryhet përgjithësisht me kafshë ngarkese. Transporti i disa prodhimeve nga fusha në magazine, transporti i plehut organik, bazës ushqimore për blegtorinë, etj., kryhet zakonisht me karroca dore ose me shpinë (kryesisht në zonat e thyera malore dhe kryesisht nga gratë).

Cilësia e vaditjes është shumë e dobët. Vaditja në përgjithësi kryhet me krah, nëpërmjet rrjedhjes së lirë të ujit. Kjo shkakton gërryerjen e tokës dhe humbjen e shtresës më aktive të saj. Vaditja përballohet kryesisht nga gratë.

Vitet e fundit, ka disa përpjekje për mekanizimin e përpunimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Shoqata Agropuka ka ngritur një Qëndër Përpunimi në Pukë dhe ka subvencionuar ngritjen e 4 qëndrave të thjeshta të përpunimit për grupet e interesit të grave në fshatrat Qerret, Gjegjan, Qelez, e Blerim. Agropuka gjithashtu ka trajnuar gratë për të përpunuar në kushtet e familjes. Një sipërmarrës privat në qytetin e Pukës ka ngritur një linjë të thjeshtë të prodhimit të lëngut të thanës, rakisë së thanes, dhe të përgatitjes së reçelave dhe kompostove.

2.7.2. Inputet bujqësore

Në Rrethin e Pukës, rrjeti i inputeve bujqësore është i pa organizuar dhe i pa stabilizuar. Të gjitha inputet bujqësore--farëra, fidana, plehëra kimikë dhe plotësuese, pesticide të zakonshme dhe organike--tregëtohen pa siguri dhe licencë, në rrugë, në dyqane ushqimore, apo dyqanet me artikuj të përzier në fshatra. Shumica e këtyre artikujve futen në treg ilegalisht dhe nuk janë të miratuara dhe kontrolluara nga organet e specializuara. Shpesh, farërat dhe pesticidet janë të skaduara dhe nuk trajtojnë sëmundjet e ndryshme. Në shumicën e rasteve, mungon instruksioni i duhur në shqip për përdorimin e tyre dhe treëgtuesit e tyre nuk kanë njohuritë e duhura për përdorimin e tyre. Ky lloj tregëtimi përbën një rrezik serioz dhe të përhershëm për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve. Ka patur raste incidentesh dhe demtime të shëndetit të njerëzve dhe kafshëve nga mos përdorimi apo ruajtja në mënyrë jo korrekte e pesticideve dhe helmeve.

Në Pukë ka vetëm një farmaci bujqësore të licensuar që ka të punësuar një specialist të fushës. Shoqata Agropuka, në bashkëpunim me shoqatën Bioadria që ka ekspertizë në këtë fushë, ka punuar me këtë farmaci për të realizuar trajnime dhe demonstrime teoriko-praktike direkt në fushë me specialistë të Shërbimit Këshillimor të shoqatës dhe me fermerët pukjanë duke u përqëndruar në ruajtjen dhe përdorimin e inputeve bujqësore dhe veçanërisht të pesticideve e substancave të tjera që përdoren në bujqësi e blegtori, përdorimin e metodave organike dhe mekanike në luftimin e sëmundjeve të ndryshme, etj.

2.8. Agrobiznesi

Industria e agro-përpunimit në Rrethin e Pukës është në fillimet e saj. Ajo përbëhet nga një punishte e prodhimit të lëngut të thanës dhe nënprodukteve të saj në qytetin e Pukës, Qendra e Përpunimit të frutave dhe perimeve e Agropukës, dhe 4 qëndra të vogla të përpunimit të grupeve të interesit të grave në Qerret, Gjegjan, Qelez dhe Blerim. Ka interes për hapjen e një baxhoje për djathin e dhisë në Xathë dhe një baxhoje në Pukë. Gjithashtu ka përpjekje për ngritje punishtesh të vogla për prodhim vere e rakisë, por në nivel të familjes apo grupeve të vogla, në Gjegjan, Qelëz, Fierzë, etj.

Historikisht fermerët pukjanë kanë prodhuar për plotësimin e nevojave të familjes me produkte bujqësore e blegtorale dhe kanë shitur vetëm tepricat. Kështu që nuk ka një traditë marketingu. Në Pukë, prodhimi i destinuar për treg është i vogël dhe i pa-organizuar. Fermerët nuk kanë njohuritë për

paketimin dhe ambalazhimin e prodhimit dhe sidomos për marketingun. Prodhimi i vogël dhe i paorganizuar në Pukë nuk mundëson furnizimin e organizuar të tregut me produkte bujqësore dhe blektorale lokale. Kryesisht, tregu furnizohet me produkte bujqësore dhe blektorale më të lira, më të bollshme, dhe më cilësore nga tregjet e shumicës në Shkodër, Lushnjë dhe Tiranë. Mbledhja dhe përpunimi i produkteve ushqimore lë shumë për të dëshiruar. Në Pukë, nuk ka asnjë pikë grumbullimi. Zakonisht fermerët i nxjerrin vetë prodhimet e tyre në treg (qoftë bagëti të gjalla apo produkte bujqësore e blektorale) dhe vetëm kur nuk kanë sukses në shitje dhe u rrezikohet prishja e produktit fillojnë negociatat me shitësit përkatës në qytet. Kështu ata humbin dy herë, humbasin në kohë duke u perpjekur për t'i shitur vetë produktet dhe në vlerë nga rënia e cilësisë dhe firot e produkteve që ngelen me ditë pa u shitur.

Vitet e fundit, donatorë të ndryshëm kanë punuar për nxitjen e prodhimit për treg. Për shembull, shoqata Agropuka ka zhvilluar demonstrime, seminare, vizita për shkëmbim eksperience brenda dhe jashtë vendit, ditë tregu për produkte të veçanta dhe panairë lokale, pjesëmarrjen në panairët kombëtare e ndërkombëtare, etj.

Prodhimet që dalin në treg në qytetet e Pukës dhe Fushë Arrezit apo ato që shkojnë në dyqanet e specializuara i nënshtrohen kontrollit periodik dhe të programuar të institucioneve shëndetësore dhe AKU(Autoriteti i Kontrollit të Ushqimeve). Ka pak ose aspak kontroll shëndetësor e veterinar për produktet bujqësore e blektorale që prodhohen e konsumohen në fermat bujqësore.

Para viteve 2000, produktet bujqësore e blektorale të importit ishin më të kërkuara dhe më konkuresive në treg se prodhimet vendase për shkak të paketimit, ambalazhimit, dhe etiketimit. Sot gjithnjë e më shumë tregu ka kërkesë për prodhimin e vendit që ka vlera të mëdha dhe prodhohet pa përdorimin e pesticideve dhe kimikateve, megjithëse shpesh ka çmim më të lartë. Në të ardhmen duhet punuar në drejtim të uljes së kostos së lartë të prodhimit dhe rritjes së kooperimit midis fermerëve që prodhojnë për treg.

2.9. Mbeshtetja për zhvillimin rural në rrethin e Pukës

Vitet e fundit, qeveria shqiptare ka marrë vendime të rëndësishme për subvencionin e mbjelljes së pemëve frutore dhe shtimin e numrit të krerëve në blegtori të cilat kanë rritur interesin e fermerëve. Megjithatë, fermerët pukjanë kanë përfituar shumë pak nga fondi i vënë në dispozicion. Aktorët qeveritarë dhe jo-qeveritarë që veprojnë në Pukë duhet të punojnë për njohjen e këtyre vendimeve nga ana e fermerëve pukjanë dhe kriteret që duhen plotësuar për të përfituar.

20 vitet e fundit ka pasur investime të kufizuara për rehabilitimin e ujitjes. Është investuar në dy rezervuarë vaditës në Pukë (që mbulon fshatrat Qerret i Madh dhe Luf por përjashton mbulimin me ujitje të Korthpulës dhe Gomsiqes) dhe Iballë dhe në vaditje në Gjegjan. Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe donatorë të ndryshëm kanë bërë investime modeste për rehabilitimin e puseve (rezervuarëve të vegjël) dhe vijave ujitëse në fshatra. Shoqata Agropuka, në kuadrin e projekteve të ndryshme, ka mbështetur në rehabilitimin e disa kanaleve ujitës dhe rezervuarëve. Nga mungesa e fondeve janë dëmtuar plotësisht kanali ujitës në Blerim (Sakat), kanali ujitës Pezhvë-Rrape, dhe kanalet ujitës Breg, Mëzi, dhe Fierzë.

Sidoqoftë, fondet shtetërore për mbështetjen e zhvillimit rural në Rrethin e Pukës plotësojnë nevojat në një masë të vogël.

Agjensia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) është një nga financuesit më të mëdhenj në zonën verilindore të Shqipërisë, përfshirë edhe Pukën. Për të realizuar projektet e saj, MADA mbështetet në qeverinë shqiptare, Fondin Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (IFAD), dhe Fondin e OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID). Fushat kryesore ku ajo ka investuar janë: Testimi, demonstrimi dhe përhapja e teknologjive të përparuara në prodhim, përpunim dhe marketing të produkteve bujqësore; Ngritja e kapaciteteve profesionale të prodhuesve dhe përpunuesve të produkteve bujqësore të zonës malore; Përmirësimi i zinxhirëve të vlerës të produkteve agro-ushqimore; Zhvillimi i turizmit rural malor; Nxitja e organizimit të komunitetit rural dhe angazhimit të tyre në proceset e zhvillimit lokal; Nxitja e zhvillimit të aktiviteteve të tjera ekonomike rurale; Ngritja dhe forcimi i forumeve të zhvillimit të zonave malore; Përmirësimi i infrastrukturës së vogël ekonomike në zonat rurale malore; Nxitja e partneriteteve privat-privat dhe publik-privat për rritjen e investimeve në zonat rurale malore; dhe Identifikimi dhe përhapja e modeleve dhe praktikave të mira në menaxhimin e shëndetit të kafshëve.

Programi për Mbështetjen e Shoqatave Rurale (Rural Association Support Programme, RASP) ka mbështetur për “Hartimin e Planit të Turizmit të Pukës” dhe programin “Fuqizimin e Demokracisë Rurale” (i implementuar gjatë 2005-2010 në Pukë, Kukës dhe Has), si dhe projektin “Zhvillimi i praktikave të qëndrueshme për prodhimin, grumbullimin dhe marketimin e bimëve medicinale dhe aromatike në Rrethin e Pukës”. RASP ka mbështetur me këshillim, konsultim, inpute, informim, metoda pjesëmarrëse në vendim-marrje, etj.

Në rrethin e Pukës veprojnë rreth 20 organizata jo-qeveritare të zhvillimit. Nga këto, katër janë, shoqata të fermerëve: Shoqata Agropuka, Shoqata Bletërritesi Pukjan, Shoqata për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Shoqata për Mbrojtjen e Pyjeve. Në shtojcat është përfshirë lista e organizatave jo-qeveritare në Rrethin e Pukës.

Në përgjithësi, aktorët e ndryshëm që kanë vepruar në Pukë, megjithëse kanë patur programet e tyre, kanë ndërvepruar dhe bashkëpunuar edhe me aktorët e tjerë, sidomos pushtetin lokal dhe drejtoritë/departamentet lokale në vartësi të ministrive dhe institucioneve të tjera qëndrore.

2.10. Pyjet dhe prodhimet e pyllit

2.10.1. Vendi i pyjeve në rrethin e Pukës

Pyjet në Rrethin e Pukës zënë një vend të rëndësishëm pas bujqësisë dhe blegtorisë. Rrethi i Pukës konsiderohet si një territor me masive të pasura pyjore dhe me kullota. Fondi pyjor ku përfshihen zonat me bimësi pyjore, kullotat, sipërfaqet djerrë dhe inproduktive zë rreth 80% të sipërfaqes së Rrethit të Pukës. Pyjet dhe kullotat në Pukë ofrojnë prodhime, shërbime dhe funksione mjedisore të pazëvendësueshme. Banorët e zonave rurale e kanë të lidhur jetesën ngushtë me këto pasuri natyrore.

Tradicionalisht, pyjet dhe kullotat në afërsi të fshatit apo qëndrave të banuara në Rrethin e Pukës janë përdorur për prodhim dru zjarri, lëndë ndërtimi, kullotë e prodhim të bazës ushqimore për blegtorinë, etj. Pyjet dhe kullotat janë administruar në bazë kanunore duke i ndarë ato në pjesë (hamalla) për çdo familje apo fis, ku secili kishte të drejtë të shfrytëzonte vetëm në pjesën e vet. Në periudhën para regjimit socialist, pyjet në Pukë janë menaxhuar në dy forma, në formë zabelesh ose të njohur si hamalla

private dhe mira. Historikisht në traditën e Pukjanit ka qenë heqja (shfrytëzimi) për material drusor për plotësimin e nevojave të drurëve të tharë, të shtrembër dhe të prapambetur (të degraduar), duke ruajtur kështu vazhdimësinë e pyllit. Për ndërtim përdorshin lëndët e ndërtimi duke i zgjedhur ato sipas nevojës në hamallat personale ose në rast se familja nuk i plotësonte dot nevojat e saja ato merreshin në miranë e fisit, fshatit ose bajrakut.

Menaxhimi i pyjeve nga ana e shtetit daton nga 27 janar të vitit 1923 (nga ku 27 Janari u shpall si “Dita e shërbimit pyjor shqiptar”) kur u miratua “Ligji i pyjeve dhe kullosave”. Shfrytëzimi i pyjeve të Pukës nga ana e shtetit ka filluar me qeverinë e Mbretit Zog ku mund të përmendim Sharrën dhe Gatrin e Kryeziut, Sharrën me ujë të Gojanit, Sharra me ujë në Pezhve Pukë, Gatrri me ujë i Trunit, dhe sharra e Ujit të Ftohtë. Gjate periudhës së regjimit socialist, pyjet e Pukës kanë mbuluar afro 20 % të nevojave të gjithë Shqipërisë. Shfrytëzimi i pyjeve është bërë kryesisht në interes të nevojave të ditës. Ndërhyrjet e pakontrolluara, me pasojë dëmtimin dhe degradimin e masiveve pyjore, e shoqëruan për shumë vite tranzicionin nga socializmi në demokraci. Lënda drusore u bë objekt fitimprurës i kondrabandës nga persona e kompani të papërgjegjshme. Sot pyjet dhe kullotat janë të dëmtuara rëndë dhe kanë prodhimtari të ulët. Në këto sipërfaqe është prishur ekuilibri ekologjik dhe ka filluar erozioni, rrëshqitjet dhe përmytjet. Shtresa e sipërme e tokës është dëmtuar dhe gërryhet vazhdimisht. Kafshët e egra në pyll janë pakësuar. Bimët mjekësore janë të pakta dhe të zhvilluara dobët. Shkurret po bëhen gjithnjë e më të vogla dhe degëzat e tyre marrin formë gjëmbore. Pyjet dhe kullotat apo pjesë të tjera të degraduara kanë nevojë të përmirësohen.

Sot në Shërbimin Pyjor Pukë janë të punësuar 56 persona nga këto 3 femra dhe 53 meshkuj. Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë nga një specialist pyjesh të punësuar.

Si arritje pozitive të këtij sektori mund të përmenden: Ngritja e shërbimit pyjor si institucion; Legjislacioni i miratuar për mbrojtjen e pyjeve dhe burimeve të tjera natyrore; Numri në rritje i specialistëve dhe punonjësve të tjerë profesionistë; dhe Investimet për shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor si një prioritet, vlera e të cilave në vitet që vijnë do të synohet të dyfishohet.

Tabela 14. Përmbledhëse e të dhënave sipas Njësite të Qeverisjes Vendore

Nr.	Nj.Q.V.	Trungsishte ha				eti	Cungishte	Shkurre	Kullota	Urbane	Inproduktive	Ujore	Sip. imësi pyjore	Totali
		ah	pishë	breth	lis									
1	Qafë - Mali	6.60	2697.70	0	0	1193.2	984.10	13.60	61.25	0	451.4	0	0	5407.85
2	Rrape	82.25	549.90	0	18.85	1580.1	1279.45	227.65			193.1			3931.3
3	Blerim	54.50	344.80	17.7	533.30	1126.8	2259.50	78.10			390.6			4805.15
4	Qerret		1526.15			540.4	2556.35	744.55	665.60		457.8			6490.85
5	Pukë		936.20			83.6	610.75	69.50	21.75		241.05			1962.85
6	Gjegjan	5.25	2451.90		191.38	357.5	3167.26	642.25			1442.9			8258.43
7	Fushë-Arrëz		987.00	83.5		27.5	705.40	53.90			118.45	17.5		1993.25
8	Fierzë		41.00			318.2	3659.00	347.75			455			4821
9	Iballe	24.25	620.90		390.80	199.9	3594.10	399.80	85		660.16			5974.91
10	Qelëz		561.58		150.90	572.0	2349.84	139.41			923.55			4697.26
	TOTALI	172.85	10717.13	101.2	1285.23	5999.2	21165.75	2716.51	833.6	0	5334	17.5	0	48342.9

Burimi: Zyra e Ekstencionit për Këshillimin e Përdoruesve dhe Përfituesve të Pyjeve dhe Kullotave

2.10.2. Bimët mjekësore dhe prodhimet e tjera të pyllit

Bimët mjekësore, tanifere dhe etero-vajore janë ndër produktet kryesore që rriten dhe zhvillohen në fondin pyjor dhe kullor të Rrethit të Pukës. Në shumë zona të Rrethit tonë ato janë një burim i mirë i të ardhurave për shumë familje fshatare, duke zhvilluar përvojë në grumbullimin e tyre.

Bimët mjekësore, tanifere e etero-vajore janë lënda e parë bazë për industrinë farmaceutike dhe kozmetike si dhe përdoren edhe në industrinë ushqimore e kimike. Nisur nga vlera e tyre ekonomike, ekologjike dhe shkencore, ato përbëjnë një ndër pasuritë natyrore me rëndësi mjaft të madhe për Pukën.

Flora është shumë e pasur dhe përbëhet nga 3200 lloje, prej të cilave mbi 300 lloje trajtohen si bimë mjekësore, etero-vajore e tanifere. E rëndësishme është se pjesa më e madhe e këtyre bimëve i janë përshtatur rritjes dhe zhvillimit në terrene të thyera, në toka të varfëra e të thata ku bimët e tjera bujqësore nuk mund të rriten qoftë edhe me anën e kultivimit.

Bimët mjekësore përdoren në shumë aspekte si mjekim tradicional dhe aktivitete ekonomike. Mbledhja dhe përpunimi i tyre tani bëhet vetëm në familje pa një organizim nga shteti apo ndonjë kompani. Bimët mjekësore dhe prodhimet e tjera të pyllit mbledhen dhe përpunohen në familjet e fermerëve për përdorim personal ose për tregtim. Edhe mbledhja e bimëve mjekësore nga ana e subjekteve të licencuara për këtë shërbim, në shumicën e rasteve është bërë në mënyrë sporadike dhe e pa organizuar. Disa subjekteve janë të interesuara kryesisht për kërpudhën dhe disa lloje të tjera bimësh mjekësore, por asnjëherë nuk është shfrytëzuar i gjithë kapaciteti prodhues i sipërfaqes pyjore të Pukës.

Subjektet e licencuar dhe të interesuara për grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e tyre grumbullojnë një kontingjent të caktuar të bimëve mjekësore sipas tregut që ata kanë siguruar në vend dhe jashtë. Siç e përmendëm dhe më lart për bimët mjekësore në Pukë është shfaqur interes disa herë për grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e tyre nga disa subjekte. Një punë e mirë është bërë dhe nga shoqata AGROPUKA në përpunimin e bimëve mjekësore dhe kërpudhave që janë tregtuar si brenda vendit ashtu dhe jashtë.

2.10.3. Administrimi i pyjeve

Administrimi i pyjeve në Rrethin e Pukës kryhet kryesisht nga shteti. Deri para 3 vitesh, e gjithë sipërfaqja pyjore ishte nën administrimin e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Pukë. Sot rreth 60 % e kësaj sipërfaqe ka kaluar në pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore. Aktualisht po përgatitet projekt-ligji për administrimin e ri të pyjeve në Shqipëri ku pritet që 90 % gjithë sipërfaqes pyjore të kalojë nën administrimin e Njësive të Qeverisjes Vendore. Shërbimi Pyjor do të ketë rol këshillimor i cili do të ofrohet me anë të zyrës së ekstensionit e krijuar tashmë pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Pukë.

Përsa i përket administrimit të pyjeve dhe kullotave, deri në nëntor të vitit 2011 këtë rol e ka luajtur Seksioni i Administrimit dhe Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë Shërbimit Pyjor (DSHP) Pukë. Pas kësaj date dhe në vazhdim, pranë këtij institucioni është ngritur Zyra e Ekstencionit për Këshillimin e Përdoruesve dhe Përfituesve të Pyjeve dhe Kullotave. Pranë Njësive të Qeverisjes Vendore

janë krijuar po ashtu zyrat për fushën e pyjeve me specialistët përkatës të cilat dhe ato ofrojnë shërbim këshillimor për banorët e këtyre Komunave apo Bashkive.

Vitet e fundit sa vjen dhe po rritet interesi i komunitetit për menaxhimin më të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave duke synuar duke synuar tek agro-pyllumaria (në një pyll shumë funksional) që do të thotë që në pyllin e tij fermeri të ketë sa më shumë lloje pyjor dhe frutor të harmonizuar së bashku për plotësimin e nevojave të tij. Kryesisht tendenca për mbjellje të reja anon nga drurët arbor dhe dushqet nga të cilat vilen prodhime si lëndë ndërtimi, dru zjarri dhe bazë ushqimore për blegtorinë. Tendencia e fermerëve është zëvendësimi i halorëve që përbëjnë llojin kryesor të kurorave që rrethojnë fshatrat me lloje të ndryshme arborësh ku mund të përmendim, arrën, gështenjën, lajthinë. Një prirje tjetër është dhe zëvendësimi i halorëve duke ju përshtatur terrenit dhe klimës me dushqe të cilët më vonë mund të përdoren mjaft mirë për bazë ushqimore për blegtorinë, dru zjarri dhe për mbrojtjen e tokës nga erozioni kryesisht në shpatinat që ndodhen mbi zonat e banuara.

Mbështetja financiare në fushën e pyjeve dhe kullotave kryesisht është bërë nga qeveria shqiptare dhe Banka Botërore. Nga ana e shtetit dhe pse me fonde të pakta vëmendja është përqendruar kryesisht në çështjet më imediate si rehabilitimi i zonave të djegura, pyllëzimi i zonave të zhveshura nga bimësia pyjore dhe lerat ujëmbledhëse. Banka Botërore ka operuar me anë të projekteve për zhvillimin e burimeve natyrore dhe të sekuestrimit të karbonit ku janë investuar shuma të konsiderueshme në mbjelljen e dushqeve dhe akacies. Këto projekte janë zhvilluar në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore.

3. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

3.1. Konkluzione

- Megjithë numrin e vogël të popullsisë, Rrethi i Pukës është një nga rrethet me sipërfaqe të madhe në shkallë vendi. Vendndodhja në qendër të Shqipërisë Veriore, terreni i thyer malor me fshatra të banuar nga 300–1200 m mbi nivelin e detit, shumëllojshmëria e florës dhe faunës, numri i madh i zonave dhe mikrozonave klimaterike krijojnë një diversitet të dallueshëm në Shqipëri dhe më gjërë.
- Gjatë viteve të tranzicionit nga socializmi në demokraci, popullsia e Rrethit të Pukës është përgjysmuar si rezultat i migracionit në qytetet e mëdha dhe jashtë vendit. Vitet e fundit ka një stabilitet dhe shpesh herë edhe tendencë për t'u kthyer nga emigracioni.
- Infrastruktura rrugore në Rrethin e Pukës është e dobët. Nga 76 fshatra që ka rrethi, 10 prej tyre nuk kanë lidhje me rrugë automobilistike as në periudhën e verës. Shumica e komunave (Iballa, Fierza, Blerimi e Qelëza) bllokohen herë pas here nga reshjet e borës gjatë dimrit.
- Arsimi në rrethin e Pukës është një sektor që po has vështirësi të mëdha. Funksionimi me klasa kolektive e ul ndjeshëm cilësinë e nxënjes së dijeve. Mungesa e arsimit profesional ka bërë që të rinjtë që mbarojnë shkollën e mesme të mos gjejnë punë pasi nuk zotërojnë asnjë profesion.
- Sektori i shëndetësisë ka shumë probleme sidomos në punën e mjekut të familjes në fshat. Mungesa e mjekëve në komunat përkatëse ka bërë që të punësohen mjekë që nuk jetojnë në atë zonë dhe për rrjedhojë edhe të mos jenë çdo ditë pranë banorëve të komunës apo zonës që mbulojnë. Po t'u shtosh këtyre edhe mundësinë e vogël të lëvizjes të mjekëve apo personelit tjetër shëndetësor nga një familje në tjetrën për shkak të largësisë së fshatrave dhe shtëpive nga njëra-tjetra rezulton një kujdes shëndetësor i pamjaftueshëm i ofruar për banorët.
- Krahasuar me numrin e popullsisë, niveli i papunësisë në rrethin e Pukës është i lartë. Janë të regjistruar si punë-kërkues të papunë 4216 persona ose 68.3 % e forcave të afta për punë. Pothuajse gjysma e popullsisë (45.5 % e familjeve) përfitojnë ndihmë ekonomike nga njësitë e pushtetit vendor. Rrethi i Pukës është rrethi më i varfër në Shqipëri.
- Ndarja administrative e rrethit nuk është bazuar mbi kritere strikte territoriale, krahinore, dokesh, zakonesh etniko-kulturore, etj. dhe për pasojë nuk i shërben në maksimumin e mundshëm nevojave dhe kërkesave të popullsisë së rrethit.
- Bujqësia është sektori kryesor për sigurimin e të ardhurave të familjeve pukjane. Mbi 70 % e popullsisë që jeton në fshat ka si burim të vetëm të ardhurash bujqësinë. Nga ana tjetër, në 20 vitet e fundit, toka bujqësore në rrethin e Pukës ka ardhur duke u reduktuar si pasojë e lënjes djerrë, erozionit, varfërimit nga mos-qarkullimi i kulturave bujqësore, etj.
- Rrethi i Pukës ka kushte shumë të mira për zhvillimin e pemëtarisë, veçanërisht të arroveve. Politikat nxitëse nëpërmjet subvencioneve të zbatuara nga Qeveria dhe OJQ dhe donatorë të

ndryshëm kanë ndikuar ndjeshëm në shtimin e numrit të rrënjëve dhe sipërfaqeve të mbjella me pemë dhe janë një premisë e mirë zhvillimi për të ardhmen.

- Blegtoria zë peshën kryesore të të ardhurave nga sektori i bujqësisë. Por zhvillimi i saj ekstensiv ka bërë që nga ky sektor të ketë rendimente të ulëta dhe prodhim të vogël. Numri i vogël i krerëve (1.3 gjedhë dhe 5.2 krerë të imëta mesatarisht për familje fermere) nuk e justifikon angazhimin serioz të fermerëve në këtë sektor. Shembujt e rritjes së fermave që kanë mbi 50 krere të imëta dhe mbi 10 krerë gjedhë dhe rezultatet pozitive që ata kanë arritur tregojnë se mund të punohet më shumë në këtë sektor. Kapaciteti kullësor i pyjeve dhe kullotave të rrethit është për të mbajtur mbi trefishin e numrit aktual të blegtorisë së imtë.
- Bletaria ka patur një zhvillim të ndjeshëm në këta 20 vitet e fundit në Rrethin e Pukës. Megjithë shtimin mbi 7 herë të numrit të zgjojeve të bletëve dhe të prodhimit, kërkesa në tregun lokal dhe kombëtar për produktet e bletarisë është e lartë dhe nuk plotësohet.
- Mekanizimi i proceseve të punës në bujqësi dhe blegtori është në nivele shumë të ulëta. Aktualisht më pak se 15 % e tokës nën kulturë punohet me mjete të mekanizuara. Në sektorët e tjerë si blegtori, agro-përpunim, etj., mekanizimi është kufizuar vetëm në përdorimin e ndonjë makinerie të thjeshtë, kryesisht të vëna në punë me forcën e krahut.
- Imputet bujqësore janë të pa kontrolluara e të pa certifikuara dhe në shumicën dërmuese të rasteve tregëtohen jashtë të gjitha rregullave e kushteve për ruajtjen e tregëtimit të tyre, duke abuzuar me llojet, cilësinë dhe garancinë.
- Agro-biznesi mbetet pika më e dobët në zhvillimin rural të Rrethit të Pukës. Mungesa e eksperiencës, kooperimit dhe infrastrukturës kanë bërë që mbi 80 % e prodhimit bujqësor e blegtoral të destinohet për konsum në familje dhe vetëm rreth 20 % për treg. Edhe prodhimi i destinuar për treg shpesh herë nuk shitet dhe dëmtohet për shkak të marketingut të pamjaftueshëm dhe mentalitetit individualist.
- Rrethi i Pukës konsiderohet si një territor me masive të pasura pyjore dhe me kullota. Fondi pyjor ku përfshihen zonat me bimësi pyjore, kullotat, sipërfaqet djerrë dhe joproductive zë rreth 80% të sipërfaqes së Rrethit të Pukës. Pyjet dhe kullotat në Pukë ofrojnë prodhime, shërbime dhe funksione mjedisore të pazëvendësueshme. Banorët e zonave rurale e kanë të lidhur ngushtë jetesën e tyre me këto pasuri natyrore.
- Bimet mjekësore, etero-vajore dhe frutat e pyllit janë një burim i madh të ardhurash për popullsinë e rrethit të Pukës, por që deri tani nuk shfrytëzohet as 30 % e kapacitetit prodhues. Mbjellja e tokave djerrë dhe me prodhimtari të ulët me këto bimë përveçse do të mbrojë tokën nga erozioni, do të përmirësojë ambjentin duke e gjelberuar atë dhe do të ishte edhe një burim i konsiderueshem të ardhurash për popullsinë e këtij rrethi.
- Nuk ka një strategji afat-mesme dhe afat-gjatë të zhvillimit rural në bazë rrethi. Vetëm bashkitë e Pukës dhe Fushë Arrëzitet kanë strategji të zhvillimit lokal. Ndërsa Njësitë e tjera Vendore nuk kanë strategji zhvillimi si dhe as kapacitetet njerëzore dhe financiare të zhvillojnë ato.

3.2. Rekomandime

- Eshtë e nevojshme që të hartohet një strategji afat-mesme dhe afat-gjatë e zhvillimit rural në bazë rrethi. Në zhvillimin e kësaj strategjie duhet të marrin pjesë aktive të gjithë Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe anëtarët e komunitetit. Kjo strategji duhet të jetë rezultat i diskutimeve dhe analizave të thelluara dhe të pa-anshme sektoriale, krahinore dhe politiko-shoqërore. Për këtë duhet të angazhohen forcat më të afta profesionale në rreth, larg ndikimeve politiko-krahinore. Paralel me strategjinë, duhet të iniciohen plane e projekte zhvillimi për përmirësimin e infrastrukturës, duke përcaktuar më parë prioritetet e zhvillimit, për të nxitur punësimin dhe reduktuar varfërinë e tejskajshme në këtë rreth.
- Palët e interesuara--pushteti lokal, Qeveria, etj.—duhet të rishikojnë ndarjen territoriale administrative të rrethit dhe t’u përshtatin atë me nevojat reale të popullsisë, në mënyrë që banorëve t’u jepen shërbimet e nevojshme në kohe dhe me cilësi nga pushteti lokal.
- Bujqësia duhet të konsiderohet si prioritet zhvillimi edhe për të ardhmen. Masat që duhen marrë përfshijnë:
 - mbrojtjen e tokës bujqësore,
 - pasurimin e futjen e saj nën kulturë,
 - stimulimi dhe subvencionimi i mbjelljes së pemëve frutore dhe veçanarisht arroreve,
 - orientimin e fermerëve në kulturat bujqësore më fitimprurëse

Këto masa do të rrisin punësimin, reduktojnë papunësinë dhe rrisin të ardhurat për familjet fermere të këtij rrethi.

- Nxitja, stimulimi dhe subvencionimi i shtimit të numrit të krerëve në blegtorinë e imtë dhe veçanarisht i dhive, duke krijuar tufa me mbi 100 krerë, krahas përmirësimit racor të tyre duhet të jenë objektivat e te gjithë faktoreve që veprojnë në këto rreth.
- Rritja e prodhimeve të bletarisë kondicionohet nga kërkesa e tregut për produktet e bletarisë. Kjo rritje mund të realizohet si nëpërmes shtimit të zgjojeve të bletëve ashtu dhe rritjes së rendimentit.
- Rritja e shkallës së mekanizimit dhe përdorimi sipas standarteve e kushteve të sigurisë i inpueteve bujqësore duhet të jenë objektiva për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë në të ardhmen.
- Nxitja e agro-biznesit dhe prodhimit për treg, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së prodhimit dhe të një marketingu të fuqishëm, duhet të jenë në fokusin e punës së të gjitha forcave që punojnë në këtë sektor dhe të atyre mbështetëse.
- Mbrojtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i pyjeve është i lidhur ngushtë me kalimin në pronësi të Njësisve Vendore dhe në pronësi private të sipërfaqeve të planifikuara. Kjo do ta rriste përgjegjësinë, kujdesin dhe të ardhurat për menaxhuesit e tyre.

- Në sektorin e arsimit, është e nevojshme që klasat kolektive të zëvendësohen duke bërë grupimin e shkollave në qendrat më të banuara si kusht për të rritur cilësinë e nxënjes së dijeve nga fëmijet. Orjentimi drejt shkollave të mesme profesionale mbështetur në kërkesat e tregut të punës duhet të jetë një objektivë tjetër për këtë sektor.
- Në sektorin e shëndetësisë, puna duhet të përqëndrohet tek mjeku i familjes dhe rritja e cilësisë së shërbimit shëndetësor në familje.
- Ulja e shkallës së papunësisë duhet të jetë në fokusin e aktorëve të zhvillimit rural. Kjo mund të realizohet nëpërmjet nxitjes së punësimit, hapjes së vendeve të reja të punës, rritjes dhe kualifikimit profesional të njerëzve, dhe shfrytëzimit më të mirë të burimeve natyrore.

SHTOJCAT

Shtojca 1: Lista e monumenteve të natyrës në rrethin e Pukës¹

Nr.	Monumenti i natyrës	Gjendja aktuale
1	Akaciet e Migjenit	E mirë, janë krasitur
2	Bungat e varrezave në Kurthpulë	E mirë
3	Qarret e varrezave të Shënkollit në Kryezi	E mirë
4	Qarri i xhamisë së Kryezi	E mirë
5	Guri i Shenjtë	E mirë
6	Gështenjat e Kokëdodës	E mirë
7	Hurdha e Tisit	E mirë
8	Karsti i Munellës	E mirë
9	Mrizi i Ndërlugjeve	E mirë
10	Mani i Zi	E mirë
11	Pisha e Dardhës	E mirë
12	Peneplena e Gomsiqes	E mirë
13	Pisha e Shejzës	E dobët
14	Sofra e Lekës	E mirë
15	Shpella e Kaurrit	E mirë
16	Ujëvara e Kryeziut	E mirë
17	Ujëvara e Kryeziut	E mirë

¹ Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 676, datë 20.12.2002

Shtojca 2. Popullsia e Rrethit të Pukës sipas ndarjes administrative

Nr.	Emërtimi	Nr. i popullsisë	Femra	Meshkuj	Nr. i familjeve
I	Bashkia Pukë	5479	2706	2773	1584
1	Qyteti Pukë	4407	2181	2226	1289
2	Fshati Pukë	882	435	447	246
3	Fshati Lajthizë	190	90	100	49
II	Bashkia Fushë – Arrëz	5084	2563	2521	1208
1	Qyteti Fushë – Arrëz	4147	2078	2069	953
2	Fshati Fushë – Arrëz	620	326	294	168
3	Fshati Micoj	92	54	38	28
4	Fshati Lumardh	225	105	120	59
III	Komuna Iballë	2711	1355	1356	839
1	Fshati Lëvoshë	182	90	92	55
2	Fshati Iballe	998	486	512	301
3	Fshati Sapaç	155	77	78	49
4	Fshati Shopël	193	99	94	60
5	Fshati B.Epër	245	129	116	117
6	Fshati B.Vogël	436	226	210	112
7	Fshati Mërtur	203	104	99	69
8	Fshati B.Vendi	299	144	155	76
IV	Komuna Gjegjan	5006	2513	2493	1280
1	Fshati Kuzhnen	255	128	127	67
2	Fshati Rras	206	105	101	57
3	Fshati Gjegjan	987	494	493	236
4	Fshati Dom	636	318	318	150
5	Fshati Gojan i Vogël	510	259	251	133
6	Fshati Gojan i Madh	876	421	455	226
7	Fshati Shkozë	616	311	305	159
8	Fshati Kalivare	250	125	125	81
9	Fshati Kimëz	279	160	119	71
10	Fshati Mesul	391	192	199	100
V	Komuna Qafë–Mali	2234	1111	1111	570
1	Fshati Armiraj	111	57	54	26
2	Fshati Orosh	183	89	94	51
3	Fshati Lajthizë	86	39	47	17
4	Fshati Srraçë	54	30	24	19
5	Fshati Moll – Kuqe	33	17	16	17
6	Fshati Qafë – Mali	422	201	221	108
7	Fshati Lumardh	232	116	116	62
8	Fshati Kryezi	1000	502	498	248
9	Fshati Tuç	113	64	49	22
VI	Komuna Rrape	2009	983	1026	518
1	Fshati Kabash	266	129	137	72
2	Fshati Rrape	411	216	195	101
3	Fshati Bicaj	299	142	157	71

4	Fshati Meçe	103	51	52	25
5	Fshati Buhot	296	151	145	86
6	Fshati Lumzi	102	47	55	32
7	Fshati Breg	351	159	192	86
8	Fshati Blinisht	181	88	93	45
VII	Komuna Qerret	3308	1595	1713	949
1	Fshati Dush	108	47	61	36
2	Fshati Luf	400	183	217	112
3	Fshati Korthpulë	215	106	109	64
4	Fshati Plet	251	130	121	61
5	Fshati Qerret	462	222	240	128
6	Fshati Kaftallë	298	142	156	90
7	Fshati Gomsiqe	272	138	134	70
8	Fshati Kçirë	348	177	171	104
9	Fshati Luf-Pla	414	199	215	138
10	Fshati Vrrith	308	143	165	76
11	Fshati Karmë	73	30	43	22
12	Fshati Tejkodër	159	78	81	48
VIII	Komuna Qelëz	2396	1215	1181	579
1	Fshati Bushat	216	118	98	54
2	Fshati Qerret i Vogël	156	77	79	60
3	Fshati Dedaj	271	135	136	79
4	Fshati Levrushk	32	20	12	10
5	Fshati Ukth	155	78	77	33
6	Fshati Buzhalë	142	60	82	28
7	Fshati Qelëz	1065	535	530	223
8	Fshati Midhë	273	141	132	77
9	Fshati Duzhnëz	86	51	35	15
IX	Komuna Blerim	2433	1230	1203	537
1	Fshati Flet	433	271	162	136
2	Fshati Xath	437	222	215	110
3	Fshati Kulumri	136	76	60	40
4	Fshati Blerim	203	90	113	34
5	Fshati Truen	264	128	136	65
6	Fshati Qebik	270	131	139	53
7	Fshati Dardhë	690	312	378	99
X	Komuna Fierzë	2485	1239	1246	632
1	Fshati Fierzë	383	172	211	111
2	Fshati Miliska	168	96	72	61
3	Fshati Arst	240	111	129	44
4	Fshati Kokdodë	171	90	81	43
5	Fshati Bugjon	528	266	262	119
6	Fshati Porav	255	137	118	71
7	Fshati Aprripë e Gurit	194	115	79	63
8	Fshati Mzi	546	252	294	120
	SHUMA TOTALE	33133	16510	16623	8694

Shtojca 3: Lindjet dhe vdekjet 0-1 vjeç në Rrethin e Pukës në 2011 dhe disa krahasime me 2010

Nr.	Lindjet sipas ndarjes administrative	viti 2011		viti 2010	
		Lindje	Vd. 0-1	Lindje	Vd. 0-1
1.	Pukë qytet	20	1-50 0/00	14	-
2.	Pukë fshat	13	-	11	-
-	Bashkia Pukë	33	1-30.3 '	25	-
3.	Qytet Fush-Arrëz	27	-	24	1-41.60/00
4.	Fshat Fush-Arrëz	7	-	6	-
-	Bashkia Fush-Arrëz	34	-	30	1-33.30/00
5.	Komuna Luf	18	-	16	-
6.	Komuna Qelëz	14	1-71.4 '	9	-
7.	Komuna Rrape	11	-	8	-
8.	Komuna Gjegjan	13	-	40	-
9.	Komuna Qafë-Mali	20	-	11	-
10.	Komuna Blerim	13	-	8	-
11.	Komuna Fierzë	5	-	9	-
12.	Komuna Iballë	13	-	7	-
-	Rrethi	174	2-11.4 '	163	1-6.1 0/00
-	Qyteti	47	1-21.2 '	38	1-26.3 0/00
-	Fshati	127	1- 7.8 '	125	-

Shtojca 4: Kulturat bujqësore

Kultura misër

Nr	Komunat	Viti 2010			Viti 2011		
		Sip. Ha	Rend kv/ha	Prodh. kv	Sip. Ha	Rend kv/ha	Prodh kv
1	Bashkia Pukë	12	28	340	12	30	360
2	Bashkia Fush-Arrëz	35	35	1225	35	38	1330
3	Komuna Qerret	163	38	6190	163	40	6520
4	Komuna Qelëz	164	37	6060	164	41	6240
5	Komuna Rrape	78	35	2730	80	35	2800
6	Komuna Gjegjan	192	46	8830	192	50	9600
	Komuna Qafë-Mali	137	27	3690	137	30	4110
8	Komuna Blerim	185	35	6470	185	37	6845
9	Komuna Fierzë	126	33	4160	126	35	4410
10	Komuna Iballë	134	35	4690	134	37	4958
11	Rrethi	1226	38.2	44420	1228	38.4	47173

Kulrurat e perimeve

Nr	Komunat	Viti 2010			Viti 2011		
		Sip. Ha	Rend. Kv/ha	Prodh kv	Sip. Ha	Rend. Kv/ha	Prodh kv
1	Bashkia Pukë	11	220	2420	11	225	2475
2	Bashkia Fush-Arrëz	5.5	138	760	5.5	140	770
3	Komuna Qerret	40	140	5600	40	142	5680
4	Komuna Qelëz	33	160	5280	33	164	5412
5	Komuna Rrape	21	155	3255	21	156	3276
6	Komuna Gjegjan	42	160	6720	42	164	6888
7	Komuna Qafë-Mali	11	113	1245	11	114	1254
8	Komuna Blerim	19	113	2147	20	114	2280
9	Komuna Fierzë	16	128	2048	16	130	2080
10	Komuna Iballë	20	134	2680	20	135	2700
11	Rrethi	218	147.5	23155	220	149	32815

Kultura e patates

Nr	Komunat	Viti 2010			Viti 2011		
		Sip. Ha	Rend.kv/ha	Prodh. kv	Sip. ha	Rend. Kv/ha	Prodh. kv
1	Bashkia Pukë	5	230	1150	5	234	1170
2	Bashkia Fush-Arrëz	12	186	2232	12	187	2244
3	Komuna Qerret	14	200	2800	14	210	2940
4	Komuna Qelëz	12	196	2352	13	198	2574
5	Komuna Rrape	9	150	1350	9	154	1386
6	Komuna Gjegjan	13	180	2340	13	186	2418
7	Komuna Qafë-Mali	14	150	2100	14	156	2184
8	Komuna Blerim	16	160	2560	16	164	2624
9	Komuna Fierzë	14	140	1960	14	144	2016
10	Komuna Iballë	14	170	2380	14	173	2422
11	Rrethi	123	172.5	21224	124	177.2	21978

Kulturat Foragjere

Nr	Komunat	Viti 2010			Viti 2011		
		Sip. ha	Rend. kv/ha	Prodh. kv	Sip. ha	Rend. kv/ha	Prodh. kv
1	Bashkia Pukë	46	183	8410	49	190	9310
2	Bashkia Fush-Arrëz	24	135	3240	26	150	3900
3	Komuna Qerret	64	170	1088	70	186	13020
4	Komuna Qelëz	47	170	7990	50	179	8950
5	Komuna Rrape	85	130	1105	90	137	12330
6	Komuna Gjegjan	80	160	1288	85	166	14110
7	Komuna Qafë-Mali	33.5	158	5290	37	160	5920
8	Komuna Blerim	45	155	6970	47	160	7520
9	Komuna Fierzë	30	130	3900	36	136	4896
10	Komuna Iballë	76	143	10868	80	147	11760
11	Rrethi	530	153.4	81302	570	161	91716

Pemëtaria gjithsejt

Nr	Komunat	Viti 2010			Viti 2011		
		Nr. rrënjë gjithsej	Nr. rrënjë prodh.	Prodh. kv	Nr. rrënjë gjithsej	Nr. Rrënjë prodh.	Prodh. kv
1	Bashkia Pukë	10300	6000	1200	10513	6500	1310
2	Bashkia Fush-Arrëz	1750	1350	337	1875	1450	362.5
3	Komuna Qerret	47250	11800	2710	60369	12569	2891
4	Komuna Qelëz	15470	9070	2721	15870	9370	2811
5	Komuna Rrape	13320	3800	912	18120	4100	984
6	Komuna Gjegjan	19100	7000	1540	19540	7523	1655
7	Komuna Qafë-Mali	10230	3570	821	10640	3957	910
8	Komuna Blerim	7220	4170	1042	21290	4634	1158
9	Komuna Fierzë	10150	7950	1113	10527	8205	1148
10	Komuna Iballë	10880	8360	1421	18080	9020	1533
11	Rrethi	145670	63070	13817	186824	67328	14762.5

Shtojca 5: Lista e organizatave jo-qeveritare që janë aktive në rrethin e Pukës

1. Intercooperation Albania
2. Qendra informimit Aarhusit Shkodër.
3. Shoqata "AgroPuka"
4. Shoqata "Kulturore Puka"
5. Shoqata "Gratë e papuna"
6. Shoqata "Për mbrojtjen e mjedisit"
7. Shoqata "Gruaja intelektuale"
8. Shoqata e "Invalidëve te punës"
9. Shoqata te "Verbërve"
10. Shoqata e "Gjuetarëve"
11. Shoqata "Progresi i gruas malësore"
12. Shoqata "Bletërritësi Pukjan"
13. Shoqata "Për mbrojtjen e pyjeve"
14. Shoqata e "Turizmit malor dhe shumë sporteve"
15. Shoqata "Gruaja drejt integritit"
16. Shoqata "Në ndihmë te fëmijëve jetim"
17. Shoqata "Aleanca për barazi gjinore"
18. Shoqata "Në dobi të gruas shqiptare"
19. Shoqata "Kultura Islame"
20. Shoqata e "Fëmijëve jetim"

Shoqatat "Aleanca për Barazinë Gjinore" dhe "Në dobi të gruas Shqiptare" janë me seli në Tiranë por ushtrojnë aktivitetin dhe në qytetin e Pukës.